

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7314 E premte 6 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Zgjedhjet e përgjithshme të vitit të kaluar u manifestuan me një dukuri të re, e që ka të bëjë me numrin mjaft të madh të votës shqiptare të derdhur ...

Vijon në faqen 18

Nga DELVINA KËRLUKU

Ç'të mirë panë shqiptarët nga qeverisja e të majtëve



Opinion

Ditës

Parlamenti rikthehet të bëjë atë që di të bëjë më mirë. Të grindet mes vetit pa bërë asnjë punë të dobishme në shërbim të shoqërisë dhe vendit. I është rikthyer ...

Vijon në faqen 19

Nga MENTOR KIKIA

Kjo nuk është as opozita, as parlamenti që na duhet



“Interes tepër i lartë nga shqiptarët”

Lotaria Amerikane, Emily Enright: Ja çfarë iu sigurohet atyre që fitojnë

Shefja e njësisë për vizat joemigruese: Aplikantët të bëjnë kujdes me kriteret

Mesditën e 3 tetorit kanë filluar aplikimet për Lotarinë Amerikane në Shqipëri, që do të zgjasin deri më 7 nëntor të këtij viti. Në një intervistë për “News24”, Emily Enright, shefe e njësisë për vizat joemigruese, vendosi theksin mbi kualifikimin që kandidati ...

Në faqen 11

BASHA, THIRRJE SHQIPTAREVE: MERRNI NE DUAR KUVENDIN. PO NA KTHEJNE DIKTATUREN

PESE ORET E 'NGUJIMIT' TE PD-SE NE PARLAMENT

Ruçi pezullon kreun e PD-së për thyerje të rregullores, më pas e “fal”. Rama: Nuk kanë ide, duan sherr. PS miraton ligjet, LSI s’ merr pjesë



(Në foto) Deputetët e PD-së

MASA PER 10 PARTI

Mungesa e femrave në listat për deputetë, KQZ gjosit me 12 mln lekë PD-në

Në faqen 4

TESTI MBI AFESITE

Urdhri i Infermierit, ja kandidatët në Infermieri, Mami dhe Fizioterapi

Në faqet 12-13

LISTA E PERDITUSUAR

Pronarët në Shkodër, kush është kompensuar e statusi i pronës

Në faqet 16-17

NGJARJA NE ELBASAN

Sulmi ndaj policisë, gjurmët në “Audin” e blinduar zbuluan Enea Bekteshin

Në faqen 8

HISTORIA



Gruaja e denoncon për dhunë, kush është beratasi që ka marrë 4 gra

Në faqen 7

Ministria e Financave: Afatet për plotësimin e dosjes nga nipërit e ish-të dënuarve

Ish të-përndjekurit, lista e dytë me përfituesit

Trashëgimtarët do të marrin këstin e parë dhe të dytë, dokumentet

Nga ORNELA MANJANI

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërblim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevo-



jshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë joparësore, për trashëgimtarët, rreth 2.000 përfitues, të cilët do të marrin dëmshpërblim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumente. “Gazeta Shqiptare” publikon listën e plotë së bashku me analizën ...

Në faqet 20-22

PARLAMENTI DEBATET

PS miraton ligjet, PD bllokoi foltoren, LSI nuk merr pjesë në votim

Darina Tanushi

Pas disa herësh blloki mi të seancës së Kuvendit, më në fund, rreth orës 18:00, deputetët e PS-së miratuan disa ligje brenda pak minutash. Deputetët e PD-së mbanin ende të bllokuar foltoren e Kuvendit, me kërkesën që të kishte debat për reformën zgjedhore. Fillimisht pati disa ndërprerje të seancës gjatë paradites. Më e fundit ishte ajo e orës 13:00, kur kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi njoftoi rifillimin e seancës në orën 18:00. Gjatë këtyre orëve, mes kreut të grupit të PD-së, Edmond Spaho e socialistëve Ruçi e Balla pati negociata për ta vijuar seancën për reformën të hënën. Por duket se negociatat nuk arritën në një pikë të përbashkët. E kështu, në fillim të seancës së orës 18:00, kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi pasi hodhi në votim pjesëmarrjen, kaloi

Ruçi i "fal" dënimin Bashës, Rama: S'kanë ide, duan sherr

Ballë: Iku koha kur Kuvendi ishte teatër i pakëndshëm

edhe disa ligje që ishin në rendin e ditës. Në sallë ishin edhe deputetët e LSI-së, por nuk morën pjesë në votim. Ai deklaroi para deputetëve: "Sa për sqarim, duke qenë se deputeti i ndëshkuar është për herë të parë, po kështu edhe për herë të parë deputet, njoftoj deputetët dhe opinionin publik që nuk po ushtroj kompetencën që më jep rregullorja si kryetar i Kuvendit për

të thirrur Byronë e Parlamentit për të marrë masa akoma më të rënda për situatën e sotshme". Pas kësaj, ai e deklaroi të mbyllur këtë seancë. Pas mbylljes së punimeve dhe deklaratës së kryetarit të PD-së, Lulzim Basha, reagoi edhe kryeministri Edi Rama, në "Twitter". "S'kanë ide, duan sherr: U dhamë konsensus për atë që donin, po prapëseprapë e bllokuan foltoren. A di të ma

thotë kush si mund të ndihmohen?", shkroi Rama. Më herët, pas seancës, kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, Taulant Balla tha se kreu i Kuvendit nuk ka kryer asnjë shkelje të neneve të Rregullores së Kuvendit. Ai tha se PD-ja po e përdor një rast të tillë për ta kthyer në kauzë, por sipas Ballës nuk mund të jetë e tillë. "PD-ja dhe deputetët e saj kanë thyer rregulloren me të dyja

këmbët dhe thirrja ime ka qenë miqësore, që të gjendej një zgjidhje gjithmonë brenda kuadrit të rregullores. Në përfundim të kësaj seance, Konferenca e Kryetarëve të rimerrte në diskutim atë që u votua dje. Jam i bindur se kërkohen kauza, sepse e dimë hallin e PD-së, por këto nuk mund të bëhen në kurriz të Kuvendit të Shqipërisë. Nenet e rregullores sot u zbatuan ashtu siç parashiko-



hen. Ato janë të njëjta ndaj çdo deputeti". "Koha kur Kuvendi ishte një teatër jo i këndshëm, ka mbaruar një herë e përgjithmonë, dhe sot është rasti më i mirë për t'i thënë çdo deputeti që, për sa i përket rregullores së Kuvendit, jemi të gjithë të barabartë", - tha Balla.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Institucioni i Presidencës

NJOFTIM PËR SHPREHJEN E INTERESIT PËR POZICIONET E KESHILLTAREVE LIGJORE DHE EKONOMIKE PRANE KOMISIONIT PAVARUR TE KUALIFIKIMIT (KPK)

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", dhe vendimit të Kuvendit nr.93/2017, shpall vendet vakante për pozicionet e **keshilltareve ligjore dhe ekonomike** per institucionin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, konkretisht për **keshilltare ligjore (12) dhe keshilltare ekonomike (4)**.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen nga data 23-27.10.2017 në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së aplikantëve, se bashku me dokumentet perkatese, pranë institucionit të KPK-se në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë, zyra e protokollit, nga e Hëna-Premte, ora: 09:00-16:00.**
- Kërkesës me shkrim dërguar me postë zyrtare në adresën: **Rruga e Kavajes, Ish-Lidhja e Shkrimtareve, Tiranë.** Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda dates 27/10/ 2017, i cili duhet të vërtetohet me fletë-mandatin e lëshuar nga institucioni

përkatës postar. KPK konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

- Kërkesë për aplikim përmes postës elektronike në adresën: komisionipavarurikualifikimit@gmail.com; tek institucioni i KPK-se, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përcakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar të aplikojë. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- a) **jetëshkrim profesional**, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
- b) **kopje të dokumenteve të noterizuara ose të njësuara nga organi përkatës, që vërtetojnë kushtet e parashikuara në nenin 22, pika 3 (per keshilltare ligjore) dhe pika 4 (per keshilltare ekonomik) te ligjit 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.**



ENKELEJD ALIBEAJ

Deputeti Enkelejd Alibeaj e quajti të padrejtë përjashtimin e Bashës. "Përjashtimi i Bashës nga seanca plenare është i padrejtë. U treguam bujarë me mazhorancën, i dhamë kohë deri në orën 16:00 dhe më pas i propozuam orën 18:00. Ky nuk është tempulli i Gramoz Ruçit, opozita do të qëndrojë këtu deri në fillimin e seancës. Ata nuk e përballojnë dot argumentin. Nuk lejohet që t'i mbyllet goja opozitës", tha Alibeaj.

Berisha: Mazhorancën nuk e zë dhjetori, ka frikë të flasë



Ish-kryeministri Sali Berisha akuzoi dje jashtë Parlamentit kreun e Kuvendit, Gramoz Ruçi se po përdor metoda të vjetra të policisë sekrete hoxhiste në drejtimin e Kuvendit. Berisha nuk nguroi të bëjë edhe një parashikim për qeverinë se nuk e kap muaji dhjetor. "Shumica po tregon se dhjetori, siç e ka nisur nga frika dhe tmerr, nuk e zë. Kanë frikë nga fjala. Çfarë po kërkon opozita aty? Kërkon që komisioni në dritën edhe të raportit të OSBE të bëjë një diskutim. Këta nuk duan diskutim. Gramoz Ruçi po fut në parlament metodat e vjetra të policisë sekrete hoxhiste në drejtimin e saj. E paralajmëroj të heqë dorë se janë absolutisht të patolerueshme", deklaroi z.Berisha. Për votimin elektronik, ai bëri të ditur se është tërësisht i mundshëm. "Është jetik për votën e emigrantëve, është jetik për votën e qetë të shqiptarëve, është plotësisht i mundshëm. Është e vërtetë që OSBE-ODIHR nuk e preferon shumë, nuk po hyj të merrem me arsyet e tyre, por pavarësisht kësaj, kjo metodë po vjen duke zënë vend më shumë. Aplikohet në një sërë shtetesh, në Britani", u shpreh z.Berisha. Sa i takon performancës së kritikëve të Bashës për ringritjen në PD, Berisha deklaroi: "Kam lexuar në media, por ajo platformë nëse është origjinalja, i dorëzohet kryesisht së PD dhe bëhen vlerësimet. Jam jashtë çdo funksioni në PD".

AKUZA

Ish-kryeministri Sali Berisha deklaroi dje pas ndërprerjes së seancës së mazhorancën nuk e zë dhjetori në pushtet, pasi ka frikë të flasë. Berisha theksoi se Ruçi po sjell në Kuvend metodat e vjetra hoxhiste të policisë.

Ruçi përjashtoi kreun e PD-së nga seanca, opozita ngujohet 5 orë në Kuvend

Basha, thirrje shqiptarëve: Merrni në duar parlamentin!

PD, grup pune për të analizuar rregulloren e Kuvendit

Valentina Madani

Seanca e djeshme parlamentare u shoqërua me debate të ashpra, pasi opozita kërkoi të diskutohet për Komisionin e Reformës Zgjedhore, pasi deputetët ishin përgatitur ndryshe nga PS-LSI, që kërkuan shtyrjen për javën e ardhshme. Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi ndërpreu dy herë me nga 5 minuta punimet e parlamentit pas debateve të ashpra me kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha. Ruçi i tërhoqi vëmendjen kreut të demokratëve për "pushtim" të foltore, pasi nuk largohej, edhe pse i kishin përfunduar minutat për diskutim. Në këtë moment, deputetët demokratë u ngritën në këmbë duke rrethuar foltoren e Parlamentit. Në kushte të tilla, kreu i Kuvendit u detyrua të ndërprejë seancën për 5 minuta dy herë radhazi. Debatë nisi për Komisionin e posaçëm parlamentar të Reformës Zgjedhore. Grupi parlamentar i PD kërkonte që të bëheshin diskutime për Komisionin e Reformës Zgjedhore, pasi kishin depozituar kërkesën në sekretarinë e Kuvendit. Ndërkohë, me miratimin e grupit të PS dhe të LSI u votua që ky diskutim të bëhej seancën e radhës, në mënyrë që të përgatiteshin të gjitha palët. Pas votimit që diskutimi të shtyhej të enjten e ardhshme, Basha i kërkoi Gramoz Ruçit që të mbledhte Konferencën e Kryetarëve për këtë çështje dhe të mos i heqë opozitës të drejtën për diskutim. Me opozitën në foltoren e Kuvendit dhe me socialistët dhe LSI-në që vendosën me votë



ta zhvillojnë javën e ardhshme debatin, kreu i Parlamentit nuk nguroi kur dha vendimin për kryetarin e PD. "Edhe njëherë ju bëj apel, zoti Basha! Atëherë jap masën e përjashtimit nga seanca plenare të deputetit Lulzim Basha", komunikoi Ruçi. Seanca u ndërpre disa herë, por opozita nuk doli prej sallës së Parlamentit, edhe pse punimet u lajmëruan për në orën 18 pasdite. Deputetëve demokratë iu bashkua edhe ish-kryetari Berisha, i cili kishte dalë përpara ndërprerjes përfundimtare. Ruçi paralajmëroi rifillimin e seancës në orën 18 të pasdites së djeshme, por opozita nuk u largua nga salla e Kuvendit, duke qëndruar e "ngujuar" për 5 orë me radhë.

QËNDRIMI

Pas mbylljes së seancës së pasdites, e cila zgjati vetëm disa minuta, kryetari i PD, Lulzim Basha deklaroi se paqja sociale është e rrezikuar. Për këtë, ai tha se opozitës i lind drejta që t'u

bëjë thirrje qytetarëve që të marrin në dorë parlamentin. "Parlamenti është vendi ku debati politik zhvillohet në respekt të fjalës së lirë dhe në respekt të qdo qytetari shqiptar, pavarësisht bindjeve politike. Edhe kur mendimet janë krejtësisht të paptjueshme, është ky Parlament që garanton paqen sociale dhe bashkekzistencën demokratike. Me fjalë të tjera, nëse në këtë Parlament vendoset të rikthehet edhe njëherë regjimi diktatorial, që për 50 vite ndaloi mendimin ndryshe dhe ekzekutoi në të gjitha format dhe mënyrat opozitën dhe mendimin kundër, atëherë ka ardhur koha të themi të vërtetën troç; paqja sociale është e rrezikuar, bashkekzistenca demokratike është e rrezikuar dhe opozitës i lind jo vetëm e drejta, por detyrimi t'u bëjë thirrje shqiptarëve të marrin Parlamentin në duart e tyre", u shpreh z.Basha. Kreu i opozitës deklaroi gjithashtu se PD do të shqyrtojë gjend-

VENDIMI

PD vendosi pas mbledhjes së grupit parlamentar që të kërkojë mbajtjen e seancës parlamentare për reformën zgjedhore ditën e hënë. Gjithashtu, PD do të ngrejë grup pune për të analizuar rregulloren e Kuvendit, pasi sipas tyre, mazhoranca po i ngushton hapësirat opozitës.

jen dhe më pas do të marrë një vendim. Por, ai tha se PD, aleatët dhe qytetarët nuk do lejojnë që Rama dhe Ruçi ta kthejnë Shqipërinë 30 vjet prapa. "Pas këtij atentati ndaj demokracisë, grupi parlamentar i Partisë Demokratike do të shqyrtojë këtë gjendje të rëndë dhe do të rekomandojë hapat e mëtejshëm që Partia Demokratike, jo vetëm grupi parlamentar i saj, por edhe aleatët tanë he gjithë qytetarët do të hedhim së bashku. Ne nuk do të lejojmë kurrë që Gramoz Ruçi dhe Edi Rama ta kthejnë 30 vite pas orën e Shqipërisë", u shpreh z.Basha. Pas mbylljes së seancës plenare të Kuvendit dhe përjashtimit të Lulzim Bashës nga Kuvendi vetëm për ditën e djeshme nga Gramoz Ruçi, kreu i PD, Lulzim Basha thirr mbledhjen e grupit parlamentar me urgjencë, seancë që ka zgjatuar disa minuta. PD vendosi që të kërkojë mbajtjen e seancës parlamentare për reformën zgjedhore ditën e hënë. Gjithashtu, PD do të ngrejë grup pune për të analizuar rregulloren e Kuvendit, pasi sipas tyre, mazhoranca po i ngushton hapësirat opozitës.

Boçi: Agravimi i debatit varet nga qëndrimi i Ruçit



Deputeti demokrat, Lulzim Boçi deklaroi dje se veprimi i Gramoz Ruçit sot duke përjashtuar kreun e PD ishte një veprim arbitrar. Situa e sotme ishte absurde, ajo përplasje që u krijua, e cila u shoqërua me penalizimin e kreut të opozitës ishte një formë e shfaqjes së arbitraritetit të drejtimit të seancës nga një person siç është Gramoz Ruçi, i kontestuar nga PD pikërisht për këto cilësi që shfaqti sot. Kemi theksuar qëndrimet

tona se gardiani i telave me gjemba nuk mund të jetë gardian i fjalës së lirë", deklaroi z.Boçi. Akti më i pranueshëm sipas Boçit, do ishte që Ruçi të largohet nga kreu i Kuvendit. "Akti më i pranueshëm për ambientin politik do ishte që zoti Ruçi të vetëlargohet, të vetëdorëzojë me një kërkesë. Dhe jo që në fund të karrierës të shprehësh mllëfin e grumbulluar për kaq vite dhe duke pasur mbi supë edhe njollat e së kaluarës", tha deputeti i PD-së.

ZGJEDHJET SHKELJET

Raporti financiar, masa administrative ndaj 10 partive, s'declaruan shpenzimet e fushatës

Kuotat gjinore, KQZ gjobit PD me 12 milionë lekë gjobë

Kundër votoi anëtari i LSI-së, Veleshnja

Valentina Madani

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve gjobiti dhe PD-në me 12 milionë lekë të reja, për shkelje të Kodit Zgjedhor sa i takon zbatimit të nenit për kuotën gjinore në listat e kandidatëve për deputetë. PD-ja rezultoi e vetmja forcë politike deri tani e penalizuar nga KQZ-ja për shkelje të ligjit zgjedhor gjatë zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit. Penalizimi ndaj PD-së u miratua me 4 vota të anëtarëve të majtë, ndërsa kundër gjobës ndaj PD-së votuan Vera Shtjefni dhe Gëzim Veleshnja i LSI-së. Dy mbledhjet e fundit kur u mor në shqyrtim kjo çështje u shtynë për shkak të bojkotit që bëndë dy anëtarët e djathtë në komision. "KQZ-ja vendosi sanksionin administrativ për subjektin zgjedhor 'Partia Demokratike' në masën 12.000.000 lekë, për mospërbushjen e detyrimit të parashikuar nga neni 67, pika 6, të Kodit Zgjedhor të ndryshuar, për 12 zonat zgjedhore", thuhet në njoftimin e KQZ-së. Por 10 parti politike nuk kanë zbat-



Kreu i KQZ-së, Klement Zguri

uar ligjin për dorëzimin e raportit financiar të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 25 qershorit. Në një deklaratë për mediat, zëdhënësja e KQZ-së, Drilona Hoxha tha se, nga 18 parti që garuan në zgjedhje, vetëm tetë prej tyre e kanë dorëzuar këtë raport. "Për herë të parë, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje kanë detyrimin që 60 ditë nga shpallja e rezultati të zgjedhjeve të dorëzojnë pranë KQZ-së raport që përmban në

NDËSHKIMI
Partia Demokratike rezultoi e vetmja forcë politike deri tani e penalizuar nga KQZ-ja për shkelje të ligjit zgjedhor gjatë zgjedhjeve parlamentare të 25 qershorit. Penalizimi ndaj PD-së u miratua me 4 vota të anëtarëve të majtë, ndërsa kundër gjobës ndaj PD-së votuan Vera Shtjefni dhe Gëzim Veleshnja i LSI-së.

mënyrë të saktë të ardhurat e përfutuara apo që partia politike ka pasur në gjendje, të gjitha shpenzimet e kryera në mënyrë të detajuar, bilancin e pasurive apo dety-

rimet që ka partia politike, për periudhën nga caktimi i datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve. Afati ligjor për zbatimin e këtij detyrimi ligjor nga ana e par-

RAPORTI

KQZ-ja shprehu dje shqetësim për moszbatimin e ligjit nga ana e partive politike që morën pjesë në zgjedhjet e 25 qershorit, se nuk kanë dorëzuar ende raportin financiar të fushatës. Zëdhënësja Drilona Hoxha tha se ky detyrim ligjor është plotësuar nga vetëm 8 parti, ndërsa për 10 subjektet e tjera u paralajmëruan masa administrative.

hore vetëm 8 parti politike", deklaroi zëdhënësja Drilona Hoxha. KQZ-ja paralajmëroi masa administrative ndaj partive që kanë shkelur ligjin. "Në zbatim të ligjit 'Për partitë politike', i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të marrë masa administrative për partitë politike të cilat kanë shkelur ligjin. Aktualisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po punon intensivisht për verifikimin e raporteve të dorëzuara nga partitë politike nëse janë në përputhje me formatin e miratuar nga KQZ-ja. Raportet e dorëzuara pranë KQZ-së, do të publikohen në faqen zyrtare të KQZ-së, 'cec.org.al', brenda muajit tetor. Zbatimi i ligjit 90/2017 nga subjektet politike është një nga faktorët kryesorë të rritjes së transparencës dhe zbardhjes së financave të partive politike gjatë fushatës zgjedhore, një nga çështjet e trajtuara gjerësisht edhe në raportin përfundimtar të OSBE/ODIHR-it", u shpreh znj.Hoxhaj. Afati përfundimtar për dorëzimin e raporteve financiare ishte data 25 shtator.



Kuvendi cakton "ambasadorët" e miqësisë me botën, emrat

Parlamenti miratoi në seancën e djeshme parlamentare emrat e të gjithë kryetarëve dhe anëtarëve të delegacioneve të grupeve të miqësisë për legjislaturën e re të Kuvendit. Kryetar i delegacionit të grupit të miqësisë Shqipëri-SHBA do të jetë Ervin Bushati, Vangjel Dule për Rusinë, Saimir Tahiri për Mbretërinë e Bashkuar, për Kinën Bashkim F'ino, Mimi Kodheli për grupin me Italinë, Taulant Balla për grupin e miqësisë me Gjermaninë. Për Ukrainën është Fidel Ylli, për Zvicrën Eglantina Gjermani, për Suedinë Klotilda Bushka, për Turqinë Ilir Beqaj, për Serbinë Petrit Vasili, Edmond Leka për Spanjën, Arben Pëllumbi për Slloveninë, Albana Vokshi për Sllovakinë.



KFOR, Fungo: Shqipëria, partner shumë i besueshëm

Komandanti i KFOR-it, gjeneral major Giovanni Fungo, zhvilloi dje një vizitë zyrtare në Ministrinë e Mbrojtjes, ku u prit nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Petro Koçi. Mes tyre u diskutuan çështjet e sigurisë, si dhe vijimi i mbështetjes së vendit tonë për Operacionin e NATO-s në Kosovë (KFOR). Fungo shprehu vlerësimin për Shqipërinë dhe FA, duke i cilësuar një partner të besueshëm. Zëvendësministri Koçi theksoi se KFOR-i konsiderohet si një histori suksesi e NATO-s. "KFOR-i garanton siguri dhe stabilitet për gjithë qytetarët e Kosovës. Por, nga ana tjetër, në armi avokatë të vendosur të shndërrimit të FSK-së në Forcë të Armatosur. Kjo do i shërbejë paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe në rajon. Kjo çështje duhet të vazhdojë të diskutohet në radhët e Aleancës", - tha Z. Koçi.

SHPLLJE ANKANDI
Shoqëria përbarimorë "Corrector" shpk, zhvillon ankandin e III-të, për shitjen e pasurisë së paluajtshme,
- Trulli + Ndërtëse me sipërfaqe 116,2 m², nga e cila ndërtesa me sipërfaqe 55 m², ndodhur në Zonën Kadastrale 8562, Nr.Pasurive 2/966, Vol.31, Fq.105, e regjistruar në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë; Cmimi i ankandit të tretë është EUR 45,360 (dyzetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë euro).
Ankandi zhvillohet dt.30/10/2017, ora 16.00 në adresën, Rruga e Kavajes, Ndertesë 27, Hyrja 1, Kati i III –të, Tiranë.
Kontakt: cel. 0684000061, ose në adresën e email: armels.lore@nchb.al

Njoftim
Përbaruesi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :
"Apartament" me sipërfaqe prej 73 m² e regjistruar në regjistrin hipotekorë, vol 1, faqe 193, me nr pasurie 2413+1-17, në ZK 8592 me adresë Gyteti "Shkoder".....
Cmimi fillestar për shitjen në ankand është në masën 2,520,000 (dy milionë e pesëqind e njëzet mijë) lekë.
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 16.10.2017 ora 16.16 në Zyren e përbaruesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjakës së rrethit Gjyqësorë Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .

Njoftim
Përbaruesi gjyqësorë Gentil Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :
"Apartament" me sipërfaqe prej 127,7 m², e regjistruar në regjistrin hipotekorë me nr 82 date 02.06.2011 me volumnë 5 faqe 108 me nr pasurie 16/130+1-8, në Zonën Kadastrale 8597 me adresë, lagja "Pazari", Shkoder ;
Cmimi fillestar për shitjen në ankand është në masën 3,472,000 (tre milionë e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë) lekë .
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 13.10.2017 ora 16.16 në Zyren e përbaruesit gjyqësorë Gentil Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Perballë Gjakës së rrethit Gjyqësorë Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051, ose në Tirana Bank me nr IBAN AL74 2065 1017 0000 6003 1383 9100 .



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

ÇAMËT

"Po, në fakt kjo është edhe sfida e marrëdhënieve ndërkombëtare, që shtetet ndajnë pikëpamje të ndryshme e në fund të ditës demokracia është kompromis. Besoj se ne jemi duke punuar për të gjetur një zgjidhje kompromisi, që akomodon pikëpamjet dhe interesat e Shqipërisë dhe të Greqisë, sepse ky është një proces i vazhdueshëm", tha dje Bushati.

Ministri i Jashtëm merr pjesë në samitin ballkanik në Selanik

"Çamët", Bushati: Po punojmë për të gjetur një zgjidhje kompromisi

Kotzias: Ministeriali, dialog i sigurtë midis fqinjëve

Darina Tanushi

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtë, Ditmir Bushati mori pjesë në takimin e dytë ndërmënytor mes Greqisë, Shqipërisë, Bullgarisë dhe Maqedonisë, i cili u mbajt në Selanik. Ministri Bushati e vlerësoi këtë si takim të rëndësishëm për të forcuar e thelluar më tej marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimit. Vendet tona kanë përballuar disa momente të vështira në fushën e sigurisë, luftës kundër trafikëve të paligjshme dhe ekstremizmit të dhunshëm: "Në këtë moment po skicojmë disa fusha për të shtyrë më tej bashkëpunimin, që shprehim do na ndihmojë në procesin e integritetit si Shqipërinë, ashtu edhe Maqedoninë", theksoi ministri Bushati. Në këtë takim u diskutua mbi implikimet strategjike të situatës dhe sfidave aktuale të sigurisë në rajonin tonë, nevojën për të adresuar kushtet e reja politiko-ekonomike, adresimin e sfidave të përbashkëta, si dhe çështjet të cilat lidhen me sektorin e energjetikës. Gjatë qëndrimit në Greqi, në takimin e dytë ndërmënytor, ministri Ditmir Bushati foli për televizionin grek "ERT". Bushati tha se ky është një takim mes vendeve të Ballkanit, që ndajnë interesa të përbashkëta, përveç përkatësisë evropiane. "Është një takim i dytë katërpalësh mes vendeve në Ballkan, të cilat ndajnë interesa të përbashkëta përveç përkatësisë evropiane. Kanë administruar së bashku momente të vështira në fushën e sigurisë, krizën e refugjatëve, luftën kundër trafikëve të ndryshme dhe ekstremizmit të dhunshëm", u shpreh Bushati në lidhje me takimin. "Kësaj radhe krahas sfidave të sigurisë, jemi duke diskutuar për bashkëpunimin policor, bashkëpunimin në fushën energjetike, kur dihet se ka projekte të rëndësishme



strategjike për sa i përket rrugëve të energjisë dhe kur dihet gjithashtu impakti që ka energjia në fushën e sigurisë në reduktimin e influencës së aktorëve të tretë në rajonin tonë, por edhe në krijimin e një perspektive dhe horizonti të qartë ekonomik për gjitha vendet tona", tha Bushati. Edhe nismëtari i takimit, ministri i Jashtëm grek, Nikos Kotzias, e ka konsideruar këtë ministerial si një vend dialogu të sigurtë midis vendeve fqinje. "Ne konsiderojmë se janë të dobishme për të gjithë këto lloj bashkëpunimesh dhe ky takim. Janë takime ku bisedojmë me sinjeritet të madh se çfarë mendojmë për të ardhmen dhe çfarë problemesh duhet të zgjidhim", tha Kotzias. Ndërkohë, kreu i diplomacisë shqiptare, Ditmir Bushati, në

një intervistë për televizionin publik të Greqisë lu është referuar edhe temave, të cilat pala shqiptare ka në tryezën e bisedimeve me atë greke, për sa i përket planit të Himarës, varrezave të ushtarëve grekë, çështjes çame dhe ligjit të luftës. "Ne ende nuk kemi mbyllur pasojat e Luftës së Dytë Botërore, si për sa i përket gjendjes së luftës, ashtu edhe sa i përket respektit për komunitetin çam", deklaroi Bushati. I pyetur nga "ERT3" për konsideratën e Greqisë për çamët si bashkëpunëtorë të nazistëve, Bushati u shpreh: "Po, në fakt kjo është edhe sfida e marrëdhënieve ndërkombëtare, që shtetet ndajnë pikëpamje të ndryshme, e në fund të ditës demokracia është kompromis dhe besoj se ne jemi duke punuar për të gjetur një zgjidhje kompromisi, që akomodon pikëpamjet dhe interesat e Shqipërisë dhe të Greqisë, sepse ky është një proces i vazhdueshëm".

Kryetarja e LSI komenton deklaratat e ambasadorit të SHBA

Kryemadhi: Lu tha se krimi blen prokurorët, unë them mund të vrasë

Kryetarja e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Moni Kuka Kryemadhi e ftuar në "360 Gradë" nga Artur Zheji në Ora News, tha se nuk heq asnjë presje nga deklaratat e ambasadorit amerikan Donald Lu, në lidhje me klanet kriminale, duke shtuar LSI-ja e ka artikuluar këtë shtetësim prej dy vitesh, por nuk është dëgjuar. "Nuk dua t'i heq asnjë pikë dhe asnjë presje dhe as nuk dua t'i shtoj ndonjë fjali asaj që tha ambasadori. Është pse është pak e vonë. Sepse këtë që thotë ambasadori e kemi artikuluar gati dy vjet. Ne tashmë na janë kthyer kriminelët në policët dhe policët në kriminelë", tha Kryemadhi. "Nuk mund të them se me deklaratat mund të luftosh krimin. Ambasadori tha se paratë e kriminit do të blejnë prokurorin dhe gjyqtarin, por unë them se edhe do ta vrasim prokurorin dhe gjyqtarin", tha ajo. "Unë shpresoj që policia e shtetit duhet të bëjë një ringritje, apo rilindje në qoftë se do të këtë dëshirën për ta bërë. Është skeptike si ide, por shpresa vdes e fundit", u shpreh Kryemadhi. A



"Sjellja arrogante e Greqisë është ushqyer nga mosnjohja e gjenocidit"

Deputeti Gjanaj rezolutë për çamët në PE, PDIU: Detyrim për çdo shqiptar

Deputeti shqiptar në parlamentin belg, Ahmet Gjanaj bëri të ditur se do të dërgojë shumë shpejt në Parlamentin Evropian projektrezolutën për njohjen e gjenocidit të çamëve. Ai tha se projektrezolutën ua ka dërguar të gjithë deputetëve të partive demokratike të Parlamentit evropian për njohjen dhe sjelljen e Greqisë ndaj shqiptarëve. Partia Dretësi, Integrim dhe Unitet përbëjnë dje nismën e deputetit shqiptar në Parlamentin e Brukselit, Ahmet Gjanaj. "Ndërkombëtarizimi i çështjes çame është një detyrim për çdo shqiptar, ndaj veprimi i deputetit Gjanaj përbën një pasuri të vyer për këtë kauzë kombëtare", thuhet në deklaratën e PDIU-së. Në relacionin e rezolutës së prezantuar nga deputeti Gjanaj përmenden edhe deklaratat e ministrit të Jashtëm grek në kufi me Shqipërinë apo kërcënimet e Greqisë, e cila duke përdorur statusin e saj si vend evropian, kërkon

vazhdimisht nga Shqipëria të respektojë të drejtat e pakicës greke. "A e dini se Greqia e ka kërcënuar Shqipërinë se do ta përdorë veton e saj kundër hapjes së negociatave për të hyrë në BE, në qoftë se ajo nuk përmirëson akoma më shumë të drejtat e minoritetit grek (ndërtim shkollash të reja greke kudo, shumë më tepër se numri i nxënësve me origjinë greke dhe përpjekjen për ta zyrtarizuar gjuhën greke në jugun e Shqipërisë) dhe varrezat e reja për të ashtuquajturit 'ushtarët grekë' të rënë në luftën italo-greke në 1941-1943", është një nga pyetjet që ngre deputeti në këtë relacion. "Ne besojmë se sjellja arrogante e Greqisë është ushqyer për shumë vite nga mosnjohja e gjenocidit që ka shkaktuar dhe që i ka çuar grekët që të zhvillojnë një kompleks dhe një prirje të papranueshme raciste, në veçanti ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë!", thuhet në këtë rezolutë.



STRATI Shoqëria përbarimorë "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajtshme:

"Apartament" me sipërfaqe 62 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Kujtim Zhika, me Nr. Pasurie 5/27+4-2, Zona Kadastrale 8521, Volumi 11, Faqe 32, lënë si garanci bankës përmes kontratës së hipotekës Nr. 139 Rep., dhe Nr. 40/2 Kol., datë 19.01.2008. Çmimi fillestar i ankandit është 28,123 Euro;

"Ndërtesë" me sipërfaqe 15.5 m², me vendndodhje Lagjia "Kongresi i Elbasanit", Elbasan, regjistruar në pronësi të Luljeta dhe Sabiula Beqiraj, me Nr. Pasurie 5/61. Çmimi fillestar i ankandit është 22,680 Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.10.2017.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientin e Shoqërisë Përbarimorë "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

NUOFTIM PER SHITJE

Ne Zyren e Permbarsuesit Gjyqesor Arjan Palla me adrese Blv.Zogu i I-re, Pall.Agimi,H-2.K-3,Ap.-5-Tirane me dt. 10.10.2017 ora 16.00 zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise me nr. 1/197 +3-26,vol8, fq.48, zk 8260,lloji I pasurise apartament me sip. 73 m2 ndodhur ne Tirane,rregjistruar ne pronesi te Fazile Stafa.Cmimi me te cilin fillon shitja eshte 40579,2 Euro.

NUOFTIM SHITJE ME ANKAND

Ne date 11.10.2017 ne oren 16.00 ne zyren e permbarsuesit gjyqesor privat **Irisa Tereziu PF** me adrese ne "Rruga Fadil Rada, Pallati Danjela, Kati Perdhe, Njesia Tregtare nr.10, Tirane", zhvillohet ankandi per shitjen e pasurise se paluajtshme te llojit "Njese" me sipërfaqe totale 87.2 m², numer pasurie 15/231-N1, vol.2014-2016, ne zonen kadastrale 8551, me adrese Kavaje.Cmimi ne ankand te pare eshte ne vleren 8,329,553.6 (tete milion e treqind e njezet e nente mije e peseqind e pesedhjte e tre pike gjashte) lekë.

Rama: Pensionistët s'duhet të marrin më kartën e shëndetit dhe vërtetimin e pensionit

Ja dokumentet që s'duhet të kërkoni nga qytetarët dhe bizneset

Ahmetaj, për lehtësimin e shërbimeve për qytetarët dhe sipërmarrjen

Ornela Manjani

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj ka lëshuar një urdhër për lehtësimin e kërkesave për dokumente të shërbimeve të ofruara nga ndaj biznesit dhe qytetarëve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucioneve në varësi të saj. Përveç bizneseve që nuk do t'u kërkohej më të paktën 13 dokumente, përfitues janë edhe pensionistët, të cilët nuk do të duhet të paraqesin më kurduan të marrin shërbime as kartën e shëndetit dhe as vërtetimin e pensionit. "Pensionistët nuk kanë më arsye të bëjnë asnjë metër rrugë dhe të humbasin asnjë sekondë radhë për të marrë vërtetimin pensioni. Karta e shëndetit po njësoj, konfirmimet për gjendjen aktive të mjetit, konfirmimet për rifitim e lejes së drejtimit, vërtetimet për lejen e drejtimit, kopje e kartelës së pasurisë, kopje e kadastrës, vërtetim i pronësisë, janë të gjitha letra, dokumente që deri dje u nxinin jetën qytetarëve me shpenzimet mbi dhe nën dorë. Qytetarët duhet të refuzojnë çdo zyrë, çdo nëpunës dhe ta denoncojnë nëse ua kërkon këto të priturara më vete", tha dje Rama.

URDHRI

Urdhri i ministrit Arben Ahmetaj për "Lehtësimin e kërkesave dokumentare të shërbimeve të ofruara ndaj biznesit dhe qytetarëve nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet në varësi të saj", përmban të detajuar listën e dokumenteve që institucionet në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nuk do t'u kërkojnë më nga qytetarëve



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

DOKUMENTET

1. Certifikata e regjistrimit në QKB, përfshirë NIPT/NUIS.
2. Ekstrakt historik i kompanisë.
3. Vërtetim për posedim mjjetesh.
4. Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për tatimpaguesit E-SIG 02a e. Vërtetim për të ardhurat e realizuara në tri vitet e fundi për tender.
5. Vërtetim për individ të paregjistruar.
6. Formulari E-SIG03.
7. Vërtetim për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për individët.
8. Vërtetim për pagimin e detyrimeve.
9. Vërtetim për statusin e tatimpaguesit.
10. Vërtetim për regjistrimin e investitorit tek Drejtoria Rajonale.
11. Dëshmi penaliteti dhe vërtetim i gjendjes gjyqësore.
12. Dëshmi penaliteti dhe vërtetim i gjendjes gjyqësore.
13. Të gjitha llojet e certifikatave që gjenerohen nga sistemi i gjendjes civile.
 - a. Këto dokumente do të gjenerohen nga strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e saj të varësisë nga portali "e-Albania".
 - b. Të gjitha strukturat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucionet e saj të varësisë të njoftojnë për çdo vështrirë në zbatimin e këtij urdhri.

dhe sipërmarrjes, por do t'i sigurojnë përmes platformës elektronike "e-Albania" ose nëpërmjet komunikimit dhe ndërveprimit ndër-institucional. Pjesë e rëndësishme e këtyre dokumenteve janë një numër

konsiderueshëm letrash që përkthehen në korrupsion, pritje, shpenzime që nuk duhet t'u kërkohej më qytetarëve nga shteti, duke filluar nga certifikata personale dhe familjare. U bëj thirrje qytetarëve që të refuzojnë çdo kërkesë të çdo zyre për certifikatë në letër dhe të kërkojnë aty në sportel që cillojë që u kërkon një gjë të tillë, ta bëjë vetë. Certifikatat familjare dhe personale janë në sistem dhe nga sistemi, zyrat e shërbimit të shtetit duhet t'i nxjerrin pa asnjë qindarkë në kohë reale, për t'u dhënë qytetarëve shërbim. Vërtetimet e pensionit po ashtu", - tha Rama.

DOKUMENTET

Pjesë e rëndësishme e këtyre dokumenteve janë një numër vërtetimesh të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

KRYEMINISTRI

Në një konferencë për mediat nga Kryeministria, kreu i qeverisë, Edi Rama bëri një përmbledhje të lehtësirave që u janë krijuar qytetarëve përmes reduktimit të dokumenteve në letër. Rama listoi me radhë dokumentet që nuk do të printohen më nga qytetarët, por do të mundësohen nga zyrat e shtetit. "Dëshiroj të bëj një përmbledhje të masave të marra deri sot lidhur me një nga zotimet kryesore, por edhe një nga rrugët kryesore që janë hapur për të çliruar sa më shumë energji pozitive dhe nxitur rritjen ekonomike, që lidhet me uljen e peshës së burokracisë. Ka numër të



SONILA QATO: LEHTËSIM I PROCEDURAVE DHE THJESHËZIM I BUKROKRACISË

"Nga dita e sotme, 24 dokumente janë pajisur me vullë elektronike, të cilat mund t'i tërhiqni nga portali qeveritar "e-Albania" dhe një mori dokumentesh administrate tatimore dhe doganore nuk do ju kërkohej më në sportelet e shtetit. Këto reforma, së bashku me heqjen e qarkullimit të certifikatave e kthejnë Shqipërinë në vendin më konkurrues në rajon me numrin minimal të dokumenteve të kërkuara."

menteve të kërkuara nga qytetarët dhe sipërmarrja dhe kalimin në një nivel të ri të modernizimit dhe dixhitalizimit të tyre.

This project is funded by the European Union

CALL FOR PROPOSALS ANNOUNCEMENT

Terre des hommes (TdH) in partnership with Institute for Strategic Dialogue (ISD), Center for Common Ground (CCG) and Beder University is implementing the project "Strengthening Civil Society to build youth resilience to Violent Extremism", funded by the European Union.

The initiative aims to contribute to ensuring the active participation of civil society in preventing/countering violent extremism through building youth resilience by empowering CSO's working with young people and communities. In this framework a Call for Proposal under the Sub-Granting Scheme is effective **29th September 2017-30th October 2017**.

The overall amount made available under this Call for Proposals is **EUR 201,000**. Tsh Albania aims to award around 25 projects, which must fall between the following minimum and maximum amounts:

1st category: - **5,000 EURO** (up to 5 projects)
 2nd category: **5001-7,500 EURO** (up to 10 project)
 3rd category: **7,501-10,000 EURO** (up to 10 project)

The deadline for the submission of applications is **30 October 2017 at 17:00**. The application package and related information must be found to the following links: <https://www.facebook.com/search/top?q=terre%20des%20hommes%20albania> www.cildhub.org

A copy of the Guidelines and Application package can be additionally requested through sending an email at: info@tdhalbania.org

This project is funded by the European Union

THIRRJE PËR PROJEKT PROPOZIME

Terre des hommes (TdH) në partneritet me Institutin për Dialog Strategjik (ISD), Qendrën për Baza të Përbashkëta (CCG) dhe Universitetin Beder, po zbaton projektin "Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Ngritjen e Reziliencës Rinore ndaj Ekstremizimit të Dhunshëm", financuar nga Bashkimi Evropian.

Kjo iniciativë synon të kontribuojë në pjesëmarrjen e shoqërisë civile në parandalimin e ekstremizimit të dhunshëm nëpërmjet ngritjes së reziliencës rinore duke fuqizuar organizatat të cilat punojnë me të rinjtë dhe komunitetin. Në këtë kuadër, Terre des Hommes në Shqipëri, hap një Thirrje për Projekt Propozime nëpërmjet skemës së Sub-Grantimit. Kjo Thirrje për Projekt Propozime do të qëndrojë e hapur gjatë periudhës **29 Shtator - 30 Tetor 2017**.

Totali i shumës për t'u kontraktuar nën këtë Thirrje për Projekt Propozime është **201,000 EURO**

Tdh Albania synon të krontaktojë rreth 25 projekte, të cilat ndahen sipas kategorive të mëposhtme:

Kategoria e parë: - **5,000 EURO** (deri në 5 projekte)
 Kategoria e dytë: **5001- 7,500 EURO** (deri në 10 projekte)
 Kategoria e tretë: **7,501- 10,000 EURO** (deri në 10 projekte)

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve është **30 Tetor 2017, ora 17:00**.

Dokumentat e aplikimit dhe informacionin më të detajuar për mënyrën e aplikimit mund të gjeni në adresat e mëposhtme: <https://www.facebook.com/search/top?q=terre%20des%20hommes%20albania> www.cildhub.org

Një kopje e udhëzimeve për Projekt Propozime dhe dokumentat e aplikimit mund të kërkohej edhe duke dërguar një e-mail në adresën: info@tdhalbania.org

Përmes një procesi transparent dhe të monitoruar, si gjatë zhvillimit të testimit dhe të korigjimit me skantron u zhvillua konkurrimi për pranimin në Akademinë e Sigurisë. Në përfundim të këtij procesi u shpallën 100 studentët fitues, të cilët do të ndjekin ciklin e studimeve bachelor. Pyetjet e testit u hartuan nga një komision i posaçëm, nga pedagogë të

Shpallen 100 studentët fitues që do të ndjekin shkollën për gradën "Nënkomisar"

Akademisë së Sigurisë. Testi përbante pyetje alternative dhe korigjimi i tij u bë sipas procedurave standarde të korigjimit elektronik, me skantron menjëherë pas përfundimit të testit. Në funksion të zhvillimit të një pro-

cesi të hapur, të drejtë, të paanshëm dhe transparent, duke marrë në konsideratë diferencën e ngushtë të konkurrentëve që u kualifikuan në fazën e parë, u vendos që edhe faza e dytë, ajo e testit psikologjik të zhvillohej

me shkrim dhe e monitoruar për të shmangur subjektivizmin. Rezultatet e testimit u shfaqën në mënyrë automatike, në sallën ku u zhvillua testimi dhe në praninë e gjithë aplikantëve. Interesi për të ndjekur Akademinë e



Sigurisë ishte i lartë. Në fazën e parë u regjistruan 563 aplikantë, nga të cilët u kualifikuan 291 prej tyre. Komisio-

ni i Vlerësimit të Rezultatit shpalli listën fituese me 100 konkurrentë, që u renditën të parët në të dyja fazat e konkurimit. Në fund të studimeve 3-vjeçare, studentët e diplomuar gradohen "Nënkomisar" në strukturat e Policisë së Shtetit. Kjo është hera e parë që pranimit në Akademinë e Sigurisë, në të gjitha fazat u zhvilluan me shkrim dhe korigjimi u krye në mënyrë elektronike.

T. Rama: Nusja e re e shtëpisë është gruaja e katërt e djalit tonë të mitur

Xhensila Kodra

BERAT

Një ngjarje e paza kontë ka ndodhur në një fshat të Urës Vajgurore. Një 30-vjeçare, nënë e një fëmije të mitur, ka shkuar te prindërit e saj në Dibër për një gëzim familjar, por kur është kthyer në banesën e bashkëjetuesit të saj, ka zbuluar tradhtinë e këtij të fundit. Jo vetëm kaq, por ajo është përballur me një femër tjetër, e cila i është prezantuar si nusja e burrit që dashuronte. T. Rama ka mësuar se i shoqi, me të cilin jetonte prej 5 vitesh (nuk kishin bërë celebrim), gjatë kohës që ndodhej emigrant në Greqi, ishte dashuruar me një vajzë nga një fshat i Beratit, Anduela R. Mësohet se kjo ishte zgjedhja më e fundit e Reli H. Kjo për faktin se 31-vjeçari ka pasur lidhje edhe me 3 femra të tjera, ku me të dytën ka pasur edhe celebrim dhe ish-in prindër të dy fëmijëve. Pas përballjes, H. i ka kërkuar nënës së fëmijës së tij që të largohet nga banesa dhe të kthehet te prindërit e saj, pasi ai nuk ndjente më për të dhe do të lidhte jetën me Anduelën. Tejet e tronditur, e reja me origjinë nga Dibra ka bërë denoncim në polici. Ajo ka treguar me detaje të gjithë ngjarjen. Pas kallëzimit, policia mori në pyetje 31-vjeçarën dhe familjarët e tij,

"Si më tradhtoi burri pas 5 vitesh, të dashurën e gjeta në banesë"

30-vjeçarja: Im shoq më tha 'ik, do martohem me tjetrën'

si dhe Anduela R. "Më datë 27.09.2017, u plotësua kërkesë-padia për lëshimin e urdhrat të mbrojtjes të menjëhershëm, për shtetasen T.R., 30 vjeçe, pasi dyshohet se bashkëjetuesi R.H., 31 vjeç, ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj saj. Materialet u referuan në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Berat. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", thuhet në njoftimin zyrtar të Policisë së Beratit.

HISTORIA

Pesë vite më parë, T. Rama ishte njohur me shkruar Reli H. dhe tani janë prindër të një djali 3 vjeç e gjysmë. Përgjatë kësaj kohe ata kanë jetuar në banesën e 31-vjeçarit, së bashku me njërin prej dy fëmijëve që ai kishte me gruan e dytë. Mësohet se me të fejuarën e parë ai ishte ndarë, pasi nëna e vajzës nuk e kishte lejuar që H. të mos e dërgon-



BABAI I 31-VJEÇARIT

Feçorr H. ka treguar në polici se i biri i kishte çuar një vajzë në banesë dhe ia kishte prezantuar si bashkëshorten e ardhshme. Ai nuk i ka thënë asnjë fjalë, pasi 31-vjeçari nuk e dëgjonte për vendimet që merrte. Më tej ai ka pohuar se djali dhe bashkëjetuesja e tij kanë pasur konflikte të vazhdueshme.

atë në shkollë. Ndërsa me gruan e dytë, me të cilën ka dy fëmijë, është divorcuar pasi sipas tij nuk kishin përputhje karakteresh. Duket se po për të njëjtën arsye, 31-vjeçari është duke u ndarë edhe me bashkëjetuesen e tretë, 30-vjeçaren me

origjinë nga Dibra. 7 muaj më parë, Reli H. kishte shkruar për të punuar në Greqi dhe pasi ishte kthyer në banesën e tij, pretendonte se i kishte kërkuar nënës së fëmijës së tij që të largohet nga banesa, pasi lidhja e tyre nuk funksiononte dhe se

kishte gjetur dikë tjetër në Greqi, të cilën ai e quante "dashuri të vërtetë".

DËSHMITË

30-vjeçarja ka treguar para uniformave blu se nuk do që të ndahet nga bashkëjetuesi i saj, për shkak se nuk do që i biri të rritet pa babain pranë. Për këtë arsye, e reja nuk u ka treguar asgjë prindërve të saj dhe se në asnjë moment nuk është larguar nga banesa e 31-vjeçarit. Ajo ka rrëfyer më tej, se ka 5 vite që jeton me Relin, por nuk kishte bërë celebrim për shkak se ai nuk kishte mbaruar ende procedurat e divorcit të parë (të cilin e ka mbyllur vitin e shkuar). T. Rama ka shpjeguar se kishte shkruar te prindërit e saj për një gëzim familjar dhe kur ishte kthyer në fshatin Drenovicë të Urës Vajgurore, kishte parë se në banesë ndodhej një grua e panjohur. Pasi i ka treguar se kush ishte, ka pyetur vjehrrën se kush ishte kjo femër, ndërsa ajo i ka

thënë se duhej të pushonte dhe të mos e pyeste më. Më vonë ka marrë vesh se vajza që ndodhej në banesë ishte sjellë nga Reli dhe e kishte prezantuar si gruan e tij të ardhshme. Ndërkaq, Reli H. ka shpjeguar se gjatë kohës që ka qenë emigrant në Greqi, në një lokal ishte njohur me Anduela R., e cila kishte qenë me pushime, dhe prej 4 muajsh kishin jetuar bashkë. "Me T. nuk kam pasur asnjëherë marrëdhënie të mira, pasi nuk ndje për të. Kur jam kthyer nga Greqia, i kam thënë se kam një person tjetër dhe duhej të ndaheshim pasi nuk kemi përputhje karakteri", - ka pohuar 31-vjeçari. Nga ana tjetër, Anduela R. ka treguar se ishte njohur me Relin 4 muaj më parë dhe se ai i kishte thënë se bashkëjetonte në Shqipëri me një vajzë që nuk e donte dhe se që nga ai moment do të jetonin së bashku. Anduela ka rrëfyer se nga Greqia ishte kthyer më datë 26 shtator dhe se Reli kishte dalë ta priste. Ai e kishte marrë me vete në shtëpinë e tij dhe e kishte prezantuar me prindërit, duke u thënë se do të ishte gruaja e tij e ardhshme. "Reli më tha se ishte ndarë nga bashkëjetuesja", - ka thënë Anduela në polici, ndërsa që prej datës 27 shtator, ajo së bashku me 31-vjeçarin janë larguar nga banesa e këtij të fundit dhe kanë shkruar në fshatin Moravë, ku jeton familja e saj.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 13,300,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halliri", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i pastrim-higjienizimit dhe i dezinfektimit të ambienteve të Bankës së Shqipërisë për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 31 Tetor 2017, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku tohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDËRSHME, GJITHÇKA ME NËNË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda lë në burg dy të arrestuarit e tjerë

ELBASAN

Enea Bekteshi, i cili u arrestua dy ditë më parë si i dyshuari kryesor për sulmin me "Audi" e blinduar ndaj policisë në Elbasan, u tradhtua nga shenjat e gishtave. Pas vënies së tij në pranga, burime nga hetuesit e çështjes bënë dije me gjatë kontrollit të automjetit me targa AA 795 EP, janë gjetur gjurmët e 31-vjeçarit. Po të njëjtat burime pohuan se nga gjurmimi i telefonit të tij celular ka rezultuar se Bekteshi ka qenë në vendin ku ndodhi përplasja. Ngjarja kjo e ndodhur mbrëmjen e 18 shtatorit të këtij viti, në lagjen "Dyli Haxhire", pranë tregut agro-ushqimor të qytetit të Elbasanit. Sipas policisë dhe prokurorisë, Enea Bekteshi ka qenë drejtuesi i mjetit të blinduar i cili goditi makinën e zëvendës-drejtorit të policisë së Elbasanit, Gjergji Oshafi. Sipas akuzës, Bekteshi është larguar në drejtim të tregut dhe më pas ka hyrë në tunelin e nëndheshëm të tregut agro-ushqimor, duke u larguar nga dera e pasme e këtij biznesi. I riu u arrestua të mërkurën nga forcat e policisë dhe FNSh-ja në banesën e kunatit të tij, Aleks Puleku (i arrestuar) në Cërrik. Ndërkohë, burimet e më-

Sulmi ndaj policisë, gjurmët në "Audi" e blinduar zbuluan Enea Bekteshin

Prokuroria: Provë edhe qelizat telefonike



I arrestuari
Enea Bekteshi



sipërme sqaruan se autori i dyshuar i sulmit ndaj policisë nuk u identifikua nga dëshmitarët dhe kamerat e sigurisë, ndaj dhe grupi hetimor kërkoi analizë të detajuar të gjurmëve në makinën e blinduar. Ato çuan te

31-vjeçari i skeduar gjë që u konfirmua edhe nga analiza e lëvizjes së qelizave të celularit të tij në zonën ku ndodhi ngjarja. Menjëherë pas ndalimit në shtëpinë e kunatit të tij në Cërrik, Enea Bekteshi u shoqërua në am-

bientet e Drejtorisë së Policisë së Elbasanit. Mësohet se ai ka refuzuar të japë deklaratime duke këmbëngulur për t'u shprehur në prani të avokatit, kur të pyetet nga prokuroria. Por, edhe në secënën e pyetjeve të së entjes, ai nuk ka dhënë detaje, duke kërkuar të mbrohet në një moment të dytë. Çështja e tij është marrë në dorëzim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Ndërkaq, dhe Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda la në fuqi masën e arrestit me burg për Ledio Zabelin (drejtuesi i makinës tip "Range Rover", e cila u ndalua para tregut agro-ushqimor në Elbasan), dhe Valmir Dedjan, rojën e tregut. Zabeli akuzohet për prodhim dhe shitje të narkotikëve, pasi atij iu gjet një sasi prej 5 gr kanabis në banesë. Ndërsa, Valmir Dedja akuzohet se nuk i është bindur urdhrat të policisë për të hapur derën e tregut. Gjithashtu, gjykata ka lënë në arrest shtëpie Kelmend Xhaferrin, i cili ishte në makinën tip "Range Rover", por që nga kontrolli në banesë iu gjet një armë gjahu pa leje.



Ish-kreu i Policisë
Elbasan, Aleks
Hajdari: Fisi Çapja nuk
ka qenë i përkëdhelur

TIRANË - Ish-drejtori i Policisë së Elbasanit, Aleks Hajdari, i ftuar mbrëmë në emisionin "Të Paekspozuarit" të gazetarit Ylli Rakipi, ka deklaruar se fisi Çapja, gjatë kohës kur ai ishte në detyrë në Elbasan nuk kanë qenë të përkëdhelur. Ai tha se nuk ka dijeni nëse fisi Çapja ka lidhje me politikën. "Unë për periudhën që kam qenë drejtor i policisë në 2009-ën, ka qenë vit zgjedhor, por s'kam dijeni që fisi Çapja ka qenë i përkëdhelur, por ka qenë në mbikëqyrjen e vazhdueshme. Ka pasur kontrolle për arsye dyshimi dhe provat janë çuar në prokurori. Flap për kohën time. Ka qenë periudhë zgjedhore, dhe nuk di që fisi Çapja të ketë pasur lidhje me politikën", - u shpreh Hajdari.

Artan Hoxha: Deri në 2015-ën, Çapjat ishin 'mbretërit' e Elbasanit, ja si nisi hasmëria me bandën rivale

TIRANË - Gazetari investigativ, Artan Hoxha ka treguar mbrëmë me detaje se si nisi konflikti që pasoi me shumë vrasje mes fiseve Çapja dhe Çela në Elbasan, të cilësua si dy bandat që sundojnë qytetin. I ftuar në emisionin "Të Paekspozuarit" në "News24", Hoxha bëri deklaratë të forta, ndërsa pohoi se deri në vitin 2015, fisi Çapja ishin 'mbretërit' e Elbasanit dhe të privilegjuar nga mazhoranca e kaluar (PD). Po ashtu ai tregoi se si nisi seria e vrasjeve pas ekzekutimit të Rezart Çelës, duke vijuar me sagën e hasmërisë mes dy bandave. Mes të tjerash ai tha se banda e Çapjave ka dorë edhe në vrasjen e ish-shefit të Qarkullimit të Elbasan, Fadil Mema si dhe ish-truproren e ish-drejtorit të Policisë së Elbasanit, Edmond Kosenit.

"Elbasani u kthye sërish në skenë. Në '97-ën ishin tri banda. Ato banda ranë, ishin shumë agresive. Ishin banda që bënin grabitje, vrasje, Policia i goditi. Disa u shpallën në kërkim. Banda e Çerikut u goditi kur PD-ja erdhi në pushtet. Një qytetar nga Italia erdhi në Elbasan dhe futi ca lojëra kompjuterike, dhe falë njohjeve që kishte, nuk paguante taksat, por më pas ai kërcënohet dhe largohet prej aty. Si administrator la një qytetar me emrin Rezart Çela. Në këto moment i kërkon Sokol Çapja që të marrë nën administrim këto makineta. Këtu nisi konflikti Çela-Çapja, ndaj Çapja paguan tre vrasje me pagesë, siç janë Armand Hasani, Dritan Sheme dhe Ardian Beqiri. I paguan 50 mijë euro. Si fillim i jep 25 mijë euro. Ata do vrisnin Çelën. Këta e vrasin dhe me vrasjen e tij, italianin humb kontrollin e makinave dhe ato i merr Çapja. Por, Çapja nuk u jep pagesën e dytë këtyre personave dhe ata e vrasin. Në shtator të 2005-ës ndodhi ngjarja. Nga ky moment nis hakmarrja mes fisit Çapja në



Artan Hoxha

drejtim të vrasësve me pagesë. Dy prej tyre janë vranë, madje iu vranë edhe vëllezë. Në 2016-ën vritet edhe vëllai i Ardian Beqirit. Elbasani kishte shpëtuar nga bandat e '97-ës dhe në këto moment dalin Çapjat. Më pas ata nisën të vrasin gjithë ata që dalin në skenë, siç ishte ish-shefi i Qarkullimit Fadil Mema, që iu bë atentat në Elbasan. Më pas u vra në 2015-ën, në Torino të Italisë. Që nga 2004-2015, njerëzit që kanë bërë goditjet dhe kanë vranë edhe ish-truproren e komisar Kosenit janë Çapjat. Janë ata njerëzit që nuk janë penalizuar dhe kanë mbajtur nën kontroll Elbasanin. Janë mbretërit e Elbasanit. Është vranë edhe ish-inspektori i Antidrogës. Gjatë 8 viteve që në pushtet ka qenë mazhoranca e djathtë, grupi që ka mbizotëruar Elbasanin dhe ka krijuar biznes të ligjshme. E panë edhe gazetarët e tu. S'e di si i çove ti ata aty, se ata të fikin derën. Ka qenë makina me logon e "News24", se ata...", - tha Hoxha.



Implemented by **giz** German-German Cooperation

ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Provider – Call for Proposal and Expression of Interest

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under the component of Technical Vocational Education & Training, will cooperate with Private Vocational Training providers in the country, with the aim to scale-up VET programs, complementary to the courses offered by Public VET providers.

In this respect the programme is conducting a Call for Proposals and Expression of Interest from 26 September – 15 October 2017.

The Call for Proposals and Expression of Interest shall help to identify private entities that can offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- training/courses with 3 - 6 months training duration for about 50 - 150 participants, targeting young people at the age of 19-34 years. 40% of the participants are female and 30% of the trainees are young returning migrants from EU countries.
 - demand-driven and work-based VT short-term courses relevant to the local labour market that lead to employment of the stated target group. The proposals should explain how employment of min. 50% of the participants after completing the training measure can be achieved.
 - There is no limitation in terms of geographical location, though high preference will be given to the locations where available vocational training offer by either public or private VET providers is non-existent or very limited.
- The courses should be in line with the following prioritized sectors – ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear, innovative/creative crafts.

The 5-7 proposals that are to be selected through this call shall receive financial support in the amount between 30,000 – 50,000 EUR (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the programme budget of 250,000 EUR assigned for this activity is allocated. The project implementation timeframe is up to 1 year (12 months).

Selection Procedure:

First step: All Call for Proposals and Expression of Interest received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potential qualified candidates will be invited for an interview and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the 5-7 companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive Expression of Interest format and Evaluation Grid.

For further questions, please, contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 26 September-14 October 2017.

I riu akuzohet për drogë e pastrim parash

Atentatet me eksploziv ndaj tregtares, mesazhe nga Londra për djalin e arrestuar

TIRANË - Atentatet me eksploziv ndaj një gruaje në Tiranë mund të jenë mesazhe që i drejtohen djalit të saj 26-vjeçar, që ndodhet i arrestuar në Londër për trafik droge dhe pastrim parash. Hetuesit në Tiranë do të kërkojnë zyrtarisht ndihmën e kolegëve britanikë për lidhjen e ngjarjeve në kryeqytetin shqiptar me luftën mes dy grupeve kriminale, në kryeqytetin britanik. Bruneta Aliaj, 55 vjeçe, është vënë sërisht në shënjestër të sulmeve me eksploziv. Paraditen e së mërkurës, në hyrje të

dyqanit të saj pranë Tregut Elektrik në kryeqytet është gendur një kallëp tritoli me fitil përcjellës e bërë gati për shpërthim. Ky është rasti i dytë që 55-vjeçarja bëhet objekt sulmi me eksploziv. Hera e parë ndodhi mbrëmjen e 1 majit, kur automjeti i saj tip "Smart" shpërtheu pranë Prokurorisë së Përgjithshme ku dhe ka banesën. Megjithatë Bruneta Aliaj mohon se ka konflikte dhe kërcënime, e vërta sipas hetuesve qëndron

ndryshe. Një burim i sigurt i tha "Klan Plus" se në të dyja rastet tritoli është një mesazh që i dërgohet djalit të 55-vjeçares. M.M., prej vitesh emigrant në Britaninë e Madhe, është një person i njohur për autoritetet policore të Londrës. Sipas të dhënave nga agjencitë ligjbatuese në Britaninë e Madhe, 27-vjeçari është i dyshuar si i përfshirë në trafikun e drogave të forta, 6 muaj para atentatit të parë që shpërtheu në makinën e

nënës së tij, M.M. u arrestua në Londër në një operacion ndërkombëtar me përfshirjen edhe të FBI-së, për pastrim parash, së bashku me një shtetas spanjoll dhe një çift kinez me shtetësi gjermane dhe franceze. 4 personave iu kapën rreth 800 mijë paund në dhomën e një hoteli. 40 ditë pas atentatit, djali i Bruneta Aliajt u dënua me 20 muaj burgim për veprat penale të "Pastrimit të parave" dhe "Përfshirjes në grup krimi-



Bruneta Aliaj

nal". Hetuesit do të kërkojnë ndihmën e autoriteteve homologe të Londrës për zbardhjen e detajeve të tjera që lidhin veprimtarinë

kriminale të 27-vjeçarit, kërcënimet ndaj tij dhe lidhjet me dy rastet e vendosjes së tritolit ndaj nënës së tij në Tiranë.

V.G.: Punonjësit e grupit të gatshëm më goditën me shkopinj gome në pjesë të ndryshme të trupit

Dhunohet me shkop gome një i dënuar në burgun e Peqinit

KSHH: Trajtim çnjerëzor, hetoni rastin

TIRANË

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur në burgun e Peqinit, ku një i dënuar pretendon se është dhunuar me shkop gome nga grupi i gatshëm i Policisë së Burgjeve. Rasti është denoncuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit, i cili përmes një njoftimi për shtyp dërguar mediave, thekson se grupi i gatshëm i policisë së burgjeve dhunoi fizikisht të dënuarin me iniale V.G., i cili vuan dënim në këtë institucion.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit thotë se gardianët hynë në qelinë e tij për të kontrolluar për sende të ndaluara dhe e pyetën të dënuarin nëse posedonte të tilla. Pasi ai u ktheu përgjigje negative, grupi i gatshëm e dhunoi duke i shaktuar dëmtime në trup. Në njoftim, Komiteti Shqiptar i Helsinkit thotë gjithashtu se ka elemente të trajtimit çnjerëzor nga dhuna e ushtruar.

NJOFTIMI I KOMITETIT SHQIPTAR TE HELSINKIT

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH), në bazë të një sinjalizimi se, në IEVP Peqin është ushtruar dhunë ndaj një të dënuari, në dt. 04.10.2017 kreu një verifikim, nga ku rezultoi se, në dt. 30.09.2017, rreth orës 22:30, në Sektorin e Sigurisë së Lartë të IEVP Peqin, Grupi i gatshëm i Policisë së Burgjeve ka ushtruar kontroll për sende të ndaluara. Gjatë këtij kontrolli, uniformat e policisë së burgjeve janë futur në qelinë nr. 12 të këtij sektori, ku kanë pyetur të dënuarin e pranishëm



Burgu i Peqinit

nëse kishin sende të ndaluara. I dënuari V. G. është përgjigjur se nuk kishin sende të ndaluara.

Pas kësaj përgjigjeje, i dënuari V.G. pretendon se punonjësit e grupit të gatshëm e kanë goditur atë me shkopinj gome në pjesë të ndryshme të trupit, si në shpinë, bark dhe shpatat e këmbëve. Eksperti mjekoligjor në përberje të grupit të KSHH, pas ekzaminimit fizik të të dënuarit, konstatoi katër ekimoza në shpinë dhe një në këmbën e djathtë sipër gjurit me gjatësi nga 5-15 cm, si dhe një hematomë në bark, majtas, me gjatësi rreth 10 cm, me ngjyrë mavi dhe të kuqërremtë të theksuar. Dëmtimet e mësipërme

ishin lehtësisht të dukshme dhe të freskëta.


Të njëjtat rrethanat të kësaj ngjarjeje u konfirmuan edhe nga i dënuari tjetër L.G., i pranishëm në të njëjtën qeli. Në fakt, pas ushtrimit të dhunës, grupi i gatshëm nuk ka kontrolluar qelinë për sende të ndaluara. Në dt. 02.10.2017, ditën e hënë, i dënuari V.G. deklaroi se është vizituar nga një infermier në spitalin e IEVP Peqin.

Grupi i KSHH këqyri kartelën personale mjekësore të të dënuarit dhe Librin e Shërbimit 24-orësh të Urgjencës, ku nuk figuronte asnjë e dhënë lidhur me vizitën apo shenjat e dhunës. Në takim me drejtuesin e

IEVP Peqin mësuam se, për këtë ngjarje kishte pasur dijeni shefi i regjimit të brendshëm të burgut ndërsa vetë drejtuesi i IEVP Peqin nuk dinte gjë. Çdo punonjës i IEVP Peqin që ka marrë dijeni për këtë ngjarje kishte detyrimin ligjor të bënte menjëherë kallëzim penal pranë organeve kompetente. Është tepër shqetësuese neglizhencia ndaj kësaj ngjarjeje tepër flagrante, nga personeli që ka pasur dijeni për të. KSHH vlerëson se ngjarja e mësipërme në të cilën është ushtruar dhunë fizike ndaj të dënuarit është shumë e rëndë. Ajo përben veprë penale, madje në vështrim të Nenit 3, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka elemente të trajtimit çnjerëzor. KSHH e denon këtë veprë dhe kërkon verifikime të mëtejshme dhe marrjen e masave përkatëse ndaj personave përgjegjës. KSHH i drejtohet gjithashtu edhe Shërbimit të Kontrollit

Tregtimi i mallrave kontrabandë, procedohen penalisht 5 persona

DURRËS - Policia e Durrësit ka finalizuar një tjetër operacion kundër informalitetit të koduar "Phones & Jewellery". Në kuadër të këtij operacioni, blutë sekuestruan dhjetëra telefona celularë të markave të ndryshme, aksesore telefonash celularë dhe bizhuteri, si dhe proceduan penalisht 5 persona. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qaraku bënë me dije, se shtetasit e proceduar penalisht janë: Gj.M. 38 vjeç; E.E. 32 vjeç; L.R. 48 vjeç; B.G. 45 vjeç dhe E.S. 31 vjeç, të gjithë banues në Durrës. Në bazë të informacioneve të disponuara nga strukturat policore, gjatë kontrollit të ushtruar në sheshin "Pranvera", shtetasit Gj.M., E.E., L.Rr. dhe E.S. janë konstatuar duke tregtuar telefona celularë të markave të ndryshme dhe aksesore telefonash pa dokumentacion përkatës. Ndërsa, shtetasi B.G. u kap duke treguar bizhuteri të ndryshme (varëse dhe unaza floriri) pa dokumentacion përkatës. U sekuestruan në cilësinë e provave materiale: 90 telefona celularë të markave të ndryshme; 150 aksesore telefonash celularë; 130 bizhuteri si: varëse, unaza dhe ora dore. Materialet i kaluan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për veprime të mëtejshme, për veprat penale: "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë" dhe "Fshehje e të ardhurave" në ngarkim të shtetasve Gj.M., E.E., L.Rr dhe E.S. "Tregtimi i produkteve të falsifikuara" dhe "Fshehje e të ardhurave" në ngarkim të shtetasit B.G.



piane për të Drejtat e Njeriut ka elemente të trajtimit çnjerëzor. KSHH e denon këtë veprë dhe kërkon verifikime të mëtejshme dhe marrjen e masave përkatëse ndaj personave përgjegjës. KSHH i drejtohet gjithashtu edhe Shërbimit të Kontrollit

të Brendshëm në Burgje që kjo ngjarje të ndiqet penalisht duke zbatuar legjislacionin në fuqi. Duke marrë shkas nga kjo ngjarje, KSHH sugjeron që të merrin masat përkatëse për respektimin rigoroz të ligjit dhe parandalimin e ngjarjeve të tilla.

Fituesve nuk iu sigurohet viza, puna apo shtëpia në Shtetet e Bashkuara

Lotaria Amerikane, Emily Enright: Aplikantët të bëjnë kujdes me kriteret

"Interes tepër i lartë nga shqiptarët"

Mesditën e 3 tetorit kanë filluar aplikimet për Lotarinë Amerikane në Shqipëri, që do të zgjasin deri më 7 nëntor të këtij viti. Në një intervistë për "News24", Emily Enright, shefe e njësive për vizat joemigruese, vendosi theksin mbi kualifikimin që kandidati duhet të ketë, në mënyrë që të mund të sigurojë një punë e jetesë në SHBA. Ajo gjithashtu nënvizoi faktin se Lotaria Amerikane nuk u siguron kandidatëve një shtëpi apo një vend pune, madje edhe nëse fiton lotarinë, nuk sigurohet viza për të shkuar në SHBA. Shefja për vizat joemigruese bën thirrje për të gjithë aplikantët që të lexojnë me kujdes kriteret, pasi shumë prej tyre aplikojnë për vizë, nuk përzgjidhen pas intervistës e vetëm shpenzojnë para. Sipas saj, rreth 15 mijë shqiptarë kanë fituar Lotarinë Amerikane këto 10 vitet e fundit dhe interesi paraqitet tepër i lartë.

Prej sa kohësh aplikohet Lotaria Amerikane në Shqipëri?

Programi i Lotarisë Amerikane ka që në vitet '90 që operon në Shqipëri, pra më shumë se 25 vjet.

Sa shqiptarë aplikojnë në një vit për Lotarinë Amerikane?

Kjo është e vështirë të përcaktohet, sepse nuk e ndjekim numrin e aplikantëve këtu në Shqipëri, por një vit pas aplikimeve bëhen publikimet në qendrën e vizave në Kentaki. Ajo që mund të them është se interesi ka qenë tepër i lartë.

Sa është numri i shqiptarëve të cilët kanë fituar lotarinë që kur ka nisur programi në Shqipëri?

Nuk e di saktësisht numrin, por mund t'ju them se gjatë 10 viteve të kaluara rreth 15 mijë shqiptarë e kanë fituar Lotarinë Amerikane.

A keni një informacion për situatën e tyre në SHBA pasi fillojnë një jetë të re aty?

Nuk kemi një informacion specifik, por kur dikush merr vizën, udhëton në SHBA, jeta e tij është private. Megjithatë, mund t'ju them se shqiptarët që fitojnë Lotarinë Amerikane, iu aprovohet viza dhe shkojnë në SHBA, ata menjëherë fillojnë aplikimin për bashkim familjar, që t'u bashkohen prindërit, partnerët, motrat, vëllezërit, dhe kemi parë se janë shumë të suksesshëm. Lotaria Amerikane nuk iu siguron një punë apo një shtëpi. Madje, edhe nëse fiton Lotarinë Amerikane, kjo nuk siguron

vizën për të shkuar në SHBA.

Si paraqiten kriteret e vendosura?

Kriteret janë shumë të forta dhe aplikanti duhet të ketë një arsim të caktuar, një standard të lartë të punës, pasi duhet të jetë në gjendje të gjejë një të tillë në SHBA. Kjo është arsyeja pse duhet të tregosh se ke arsim të mesëm të barasvlershëm me atë të SHBA-ve, në mënyrë që të kualifikohesh për vizën, sepse më pas duhet të gesh punë, të blesh shtëpi dhe të ndërtohet jetën tënde në Shtetet e Bashkuara sapo të shkohet atje.

Cilat janë disa nga gabimet që kandidatët mund të bëjnë gjatë aplikimit për Lotarinë Amerikane?

Ajo çfarë shohim shpeshherë gjatë intervistës është se ka raste që kanë fituar lotarinë, por nuk kanë mundur të marrin vizën pasi nuk plotësojnë kërkesat tona për arsim. Ndonjëherë njerëzit mendojnë se nëse fitojnë, kualifikimin e duhur e ka bashkëshorti apo bashkëshortja ime dhe kështu mund të kualifikohen. Dikush mendon se oficerët mund të marrin parasysh



Emily Enright, shefe e njësive për vizat joemigruese, gjatë intervistës për "News24"

arsimin e bashkëshortit dhe në këtë mënyrë e gjithë familja do të kualifikohet. Por në fakt nuk ndodh kështu. Fituesi duhet të ketë arsimin e duhur për t'u kualifikuar. Të aplikosh për Lotarinë Amerikane është falas, por nëse fiton lotarinë

dhe vendos të aplikosh për vizë, ekziston një pagesë për këtë, që në fakt është e shtrënjtë. Prandaj i nxisim njerëzit që të lexojnë mirë rregullat, në mënyrë që të shohin nëse e kanë kualifikimin e duhur, sepse nëse nuk e kanë atë dhe aplikojnë

për vizë, shpenzojnë para dhe nuk përzgjidhen.

Cilat janë sugjerimet tuaja për të gjithë ata që do të aplikojnë këtë vit?

Lexoni mirë rregullat, sidomos kur kërkoni të kualifikoheni në bazë të punës. Për shembull mund të kual-

ifikohesh bazuar në punë nëse je menaxher ndërtimi. Ndonjëherë njerëzit mendojnë se punojnë në ndërtim, kanë vartës dy persona dhe pretendojnë se janë menaxherë ndërtimi, por ky nuk është standardi ynë. Sipas standardit tonë kërkohet që të jesh në gjendje të ndërtohet një ndërtesë që t'i rezistojë tërmetit, duhet të jesh në gjendje të menaxhosh një buxhet prej shumë milionë lekësh, duhet të mbikëqyrësh 50 veta, duhet të dish se si të përdorësh programe kompjuterike. Pra është shumë më e vështirë, por njerëzit thjesht lexojnë titullin e punës, ndaj ne bëjmë thirrje që të lexohen detajet, për të kuptuar që, nëse fiton lotarinë dhe nuk ke kualifikimin e duhur, do përfundosh duke shpenzuar para për një vizë që nuk do të mund ta marrësh dhe ndërkohë i zini vendin dikujt tjetër nga Shqipëria që është i kualifikuar. Vetëm 7 për qind e europianëve që marrin vizën mund të vijnë nga Shqipëria. Kështu që, nëse ti e di që nuk ke kualifikimin e duhur, atëherë po i zë vendin një shqiptari tjetër të kualifikuar.

Mansaku: Ja si funksionon me martesat

Specialisti: Fotografia e gabuar sjell skualifikimin e aplikantit



Lorenc Mansaku, supervisor specialist vizash duke folur për "News24"

arsimit, ose nëpërmjet përvojës së punës. Nëse kualifikohesh përmes arsimit, nuk është e nevojshme që të kesh përvojën e punës. Ne e vëmë theksin më shumë tek

arsimi, sepse pak profesione kualifikohen.

Për çfarë duhet të bëjnë kujdes aplikuesit?

Ka disa çështje për të cilat aplikantët duhet të

bëjnë kujdes. Fillimisht të lexojnë udhëzimet që janë në shqip. Gjatë aplikimit të bëjnë kujdes me foton, pasi fotografia e gabuar bën skualifikimin e aplikantit. Në momentin e aplikimit, e rëndësishme është të vendosen personat e familjes sipas statusit aktual.

Nëse një aplikant lidhet në martesë gjatë kohës që pret përgjigje, çfarë do të ndodhë me partnerin/en e tyre?

Nëse martesë është e rregullt, jo për arsye emigracioni, ata mund të lajmërojnë qendrën konsullore në Kentaki që të njoftojnë bashkëshortin ose bashkëshortin e tyre pasi të jenë përzgjedhur. Nëse nuk ka kohë dhe ka ardhur momenti i intervistës, ata mund të njoftojnë seksionin konsullor dhe ne bëjmë sh-

timet përkatëse.

Si bëhet përzgjedhja e fituesve?

Përzgjedhja është krejtësisht e rastësishme dhe bëhet në Kentaki. Ambasada amerikane apo seksioni konsullor nuk ka asnjë rol në këtë përzgjedhje kompjuterike. Shqipëria nuk merr dot më shumë se 7 për qind të vizave të përcaktuara në total. Por Shqipëria ka qenë me fat, se ka qenë me numrat lart në këtë drejtim.

Sa e vërtetë është thënia që korçarët janë më të privilegjuar për të fituar?

Është krijuar mit i gabuar, madje edhe në rrjetin social "Facebook", ku ne jemi tepër aktivë, na pyesin në lidhje me këtë temë. Por kjo nuk është e vërtetë, pasi përzgjedhja bëhet në mënyrë rastësore e kompjuteri nuk njihet njeri. Thjesht ka qenë rastësi.

DEBATI

Vendimet e Ministrisë së Kulturës: Rehabilitim e ndërtim në Butrint

Fatmira Nikolli

Shkresat e muajit maj, projekti i hartuar nga Instituti i Monumenteve u miratua me kushtin e mosprekjes së nëntokës

Më 12 maj të këtij viti, Ministria e Kulturës përmes Këshillit Kombëtar të Restaurimeve ka firmosur një vendim që i hap rrugë asaj që po bëhet sot në Butrint. Më 25 maj, një tjetër vendim është firmosur nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbështetje të parit.

Përtej videove dhe fotografive, që shfaqin betoniere, tulla e çimento, vendimi i parë thotë: Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar ditë më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës, **VENDOSI: 1.** Projektin "Rehabilitimi dhe ndërtimi i pikave të shërbimit në qytetin antik të Butrintit, Sarandë", hartuar nga IMK. **2.** Ngarkohet Qendra Kombëtare të Inventarizimit të Pasurive Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë". Dokumenti është firmosur nga ministria e Kulturës në cilësinë e kryetares së Këshillit Kombëtar të Restaurimit dhe drejtorja e IMK-së, Arta Dollani në cilësinë e sekretares së KKR-së.

Përveç faktit që vendimi në fjalë ka gabime dhe përsëritje, ose mbivendosje, dokumenti së pari parashikon ndërtim e së dyti nuk jep asnjë detaj.

Vendimi i dytë, ai i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë miraton projektin "Rehabilitimi dhe ndërtimi i Pikave të Shërbimit në qytetin antik të Butrintit - Sarandë", hartuar nga Instituti i Monumenteve me kushtin e mosprekjes së nëntokës.

Ministria e Kulturës ka deklaruar ditë më parë përmes një email-i për mediat, se "asnjë godinë e re nuk ndërtohet në Parkun Kombëtar të Butrintit, por është duke u kryer përshtatja e ambienteve ekzistuese me struktura të përkohshme dhe në përpunje me të gjithë parametrat e parashikuara nga konventat e UNESCO-s".

Në të njëjtën deklaratë, thuhet se në Parkun Kombëtar të Butrintit nuk janë duke u kryer gërmime apo ndërtime të reja, por në bazë të vendimeve ligjore dhe teknike janë duke u përshtatur objektet ekzistuese,



Punimet në Parkun Kombëtar të Butrintit

me qëllim përdorimin e tyre për kryerjen e shërbimeve të standardizuara brenda Parkut Kombëtar të Butrintit.

Nga ana tjetër, dy ditë më pas në një deklaratë për mediat, Forumi për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore ka thënë se "Të gjithë arkeologët si Neritan Ceka, Gjerak Karaiskaj, Gjergj Frashëri, e shumë zëra të tjerë profesionistë, kanë denoncuar mungesën e sondimeve arkeologjike përpara se të aprovohehin këto leje në brendësi të parkut".

Në vijim, Forumi nënvizonte se ministria "ende nuk i është përgjigjur pyetjeve kryesore që ngrenë sot të gjithë: përse duhet të ngrihen këto dy objekte në brendësi të parkut, pranë një muri prehistorik, i cili daton në shekullin e 7-8 para Krishtit? A është vërtet i domosdoshëm sigurimi i barakeve dhe shitjes së suvenirëve në brendësi të parkut, aty ku nëntoka ende nuk i ka nxjerrë thesaret e saj?".

DEBATI DHE MODELI I RI I TRASHËGIMISË

Gjithnjë e më shumë ministria Mirela Kumbaro shprehet se, "ne nuk duhet të kemi frikë të jetojmë brenda trashëgimisë. Kjo është arsyeja pse po punojmë fort për trashëgiminë si motor zhvillimi, që do të thotë më shumë të ardhura. Në 4 vjet kemi bërë të mundur që trashëgimia të kthehet në burim ekonomie". Duke lënë mënjanë akuzat me emra të përveçëm a favorizime fir-

shime në vendimin e vitit 2009, për shpalljen e Kalasë së Tiranës zonë arkeologjike A dhe miratimin e rregullores së administrimit të saj. Praktikisht, nga vendimi i qeverisë "Berisha", qeveria "Rama" pati shtuar një pikë, e cila u hap rrugë konstruksioneve në zonën arkeologjike A. Pika 4 e do-

kumentit përcakton se konstruksionet duhet të jenë maksimumi një kat dhe se duhet të jenë të lehta dru, xham, plastikë, metal. Në VKM përcaktohet se konstruksionet "duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara".



Faksimile e vendimit të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë



Faksimile e vendimit të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve

"Gazeta Shqiptare" kërkon projektin nga MK, ende nuk i është vënë në dispozicion

mash a personash që sipas akuzave kanë përfitur nga miqësitë e njohjet, ne jemi sot para një modeli të ri trashëgimie, tejet të dyshimtë në kushtet shqiptare të respektimit të ligjit dhe të llogaridhënies reale. Butrinti është veçse rasti i radhës. Pat nisur me të djathtë në pushtet e po vijon me të majtë në pushtet. Biznesmenëve u ndryshojnë veç emrat, pushtetmbajtësve po ashtu.

Më 20 prill 2016, qeveria "Rama" pati marrë një vendim, i cili ka bërë disa ndry-

TRASHËGIMIA

Duke lënë mënjanë akuzat me emra të përveçëm a favorizime firmash, a personash që sipas akuzave kanë përfitur nga miqësitë e njohjet, ne jemi sot para një modeli të ri trashëgimie, tejet të debatueshëm, tejet të dyshimtë në kushtet shqiptare të respektimit të ligjit dhe të llogaridhënies reale. Është ky tanimë modeli i ri - ndërtimet miratohen me kushte, së paku në letër, që të mos preket nëntoka.

Është ky tanimë modeli i ri - ndërtimet miratohen me kushte, së paku në letër, që të mos preket nëntoka. Zyrtarisht nëntoka nuk preket. Nga ana tjetër, pikëpyetjet janë shumë. Kemi kaluar nga ndalimet kategorike në lejime me kushte, e jemi njëherësh krenarë për historinë nga e cila vijmë e së cilës nuk dimë më çfarë do i ruajmë.

Kemi pranuar, ose kemi heshtur për "vendosjen e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal), me lartësi maksimale 1 kat, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara", duke i hapur rrugë këtij model, trashëgimisë si motor zhvillimi dhe motorë të tjerë - bëjnë zhurmë e bëjnë pis.

Duke iu rikthyer atij vendimi të prillit 2016 ku thuhet se konstruksionet, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik, që lidhen me veprimtarinë arkeologjike, në veçanti dhe trashëgiminë kulturore, në përgjithësi si dhe nevoja të tjera të rikualifikimit urban të zonës, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin - duket se duhet të kuptojmë me këtë që tanimë ky është modeli i ri. Quo vadis trashëgimia? E kush e di?

"Gazeta Shqiptare" i ka kërkuar Ministrisë së Kulturës zyrtarisht projektin për Butrintin, por ende nuk e ka marrë.

Lista emërore në Shkodër, Malësi e Madhe dhe Pukë. Kompensimi fizik e financiar, në rend kronologjik

ATP, statusi i secilës pronë në Shkodër

Emrat e pronarëve, sipërfaqja e pretenduar dhe sa kompensohet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtitimit të Pronës ka përditësuar regjistrin e saj elektronik për dosjet e pronave në të gjithë vendin. Çdo trashëgimtar pronash ka mundësi të lexojë në "Gazetën Shqiptare" statusin e dosjes së tij dhe problematikën e dokumenteve që mund të ketë secili pronar. Regjistri elektronik mban të

dhëna të detajuara për çdo aplikim dhe çdo proces që ka ndodhur me pronat që nga viti 1993 dhe deri tani për qarkun e Shkodër. Secila nga dosjet përmban emrin e subjektit të shpronësuar si dhe emrin e subjekteve që e pretendojnë atë pronë. Në dosje pasqyrohen sipërfaqja e pretenduar si dhe lloji i pasurisë, sipërfaqja e njohur, sipërfaqja e kthyer apo e kompensuar. Ndërkohë që pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e Komisioneve dhe Zyrave Rajo-

nale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për secilin subjekt, bashkë me vendimet gjyqësore dhe problematikën e secilës dosje. "Gazeta Shqiptare" nis sot publikimin e pjesës së tretë të listës së veprimeve që janë kryer me dosjet e pronave të qarkut të Shkodër. Të gjithë të interesuarit njihen gjithashtu edhe me problematikën që mund të ketë dosja e tyre, siç është mungesa e dokumenteve të caktuara. Ndërkohë, Agjencia e Trajtitimit të

Pronave ka marrë në shqyrtim dosjet në qarkun e Elbasanit, të cilat janë në proces shqyrtimi. Regjistri i dosjeve në shqyrtim pasqyron numrin e dosjes, emrin e subjektit të shpronësuar, kërkesin, llojin e pasurisë si dhe të dhënat në lidhje me sipërfaqen e njohur, sipërfaqen e kthyer dhe sipërfaqen e kompensuar. Në regjistër janë edhe të dhënat për çdo dosje për vendimet e Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si dhe prob-

lematika që ka çdo dosje, e cila pasqyron mangësinë në dokumentacion. Sot publikohet regjistri elektronik i pronave në qarkun e Shkodrës, ku përfshihen Shkodra, Malësia e Madhe dhe Puka. Dosjet ndodhen në Agjencinë e Trajtitimit të Pronave në proces shqyrtimi dhe do të trajtohen me ligjin e ri. Vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

kur subjekti kërkon të përfillojë nga pagesa e përshpejtuar, ose kërkon të jetë pjesë e tenderit për kompensimin fizik në bazë të pronave që ka vënë në dispozicion ATP-ja. ATP-ja do t'i japë përparësi kompensimit të truallit. Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe vendimi do të merret sipas rendit kronologjik të kërkesave dhe kompensimi do të shpërndahet sipas këtij rendi, me përjashtim të rasteve

LISTA E VEPRIMEVE QË JANË KRYER ME DOSJET E PRONAVE TË QARKUT TË SHKODRËS (PJESA E TRETË)

(Vijon nga numri i djeshëm)

Emri (Subjekti i shpronësuar)	Mbiemri (Subjekti i shpronësuar)	Emri (Subjekti Kërkuar)	Mbiemri (Subjekti Kërkuar)	Sip. E pretenduar, m2 & lloji i pasurisë	Zona Kadastrale	NR I Vendimit I KKKP, ZRKKP	Sip. E Njohur/ Mosnjohur e M2	Sip. E Kompensuar M2	Problematika
Murat	Plori	Murat	Plori	3000m2 truall	Domen / 1551	274	2300	2300	Ka vert.pronësie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Kin	Shkurti	Kin	Shkurti	7000m2 truall	Muriqan / 2740	273	7000	7000	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Taip	(Drini)	Nazmi	(Drini)	8000m2 truall	Mjede / 2702	272	6500	1500	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Zef	Tushaj	Zef	Tusha	Sip. E papercaktuar	Rrence / 3168	271	2500		Ka vert.pronësie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua I njohet e dr. e parablerjes se objekteve mbi sip e njohur
Shuk	Tushi	Ndoc	Tusha	Sip. E papercaktuar	Rrence / 3168	270	3500		Ka vert.pronësie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Abaz	Jakupi	Elmaz	Jakupi	800m2 truall	Oblike / 2817	268	800	800	Ka vert.pronësie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Rame	Druni	Jonuz	Druni	300m2	Bardhaj / 1105	267	300	300	Ka vert.pronësie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Idriz	Hasani	Lutfije	Haxhija	3000m2 truall	Barbullush / 1100	266	3000	3000	267/1 Kam vendimi është per percaktimin e masës së kompensimit të njohur (per zbatimin e nenit 16)
Zyhd	Kali	Bukurije	Kali	2100m2 truall	Dobrac / 1495	265	2100	2100	Ka vert.pronësie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Shtjefen	Gjondrekaj	Shtjefen	Gjondrekaj	6000m2 truall	Plepan / 2987	264	2500	500	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Jonuz	Kulluri(Fetahi)	Fadil	Kulluri	5000m2 truall	Ana e Malit / 2740	263	5000	5000	Ka vert.pronësie Ska Harte Vendimi nuk u ankimua
Filip	Simoni	Roza	Simoni	900m2 truall	Shiroke / 8591	262	900	900	Ka VFJ Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Lin	Shestani	Agetina	Shestani	Sip. E papercaktuar	Shiroke / 8591	261			Ka vert.pronësie Ka Harte Vendimi nuk u ankimua Negativ mungese dokumentacioni
Ndue	Kola	Zef	Kola	Sip. E papercaktuar	Karme Lac / 2097	259		6100	Ka vert.kadastral Ka harte Vendimi nuk u ankimua

Luk	Pjetri	Zef	Pjetri	Sip. E papercaktuar	Karme Lac / 2097	258	3000	3000	Ka vert.kadastral Ka harte Vendimi nuk u ankimua
Zef	Gjoni	Zef	Gjoni	5000m2 truall	Karme Lac / 2097	257	4000	4000	Ka vert.kadastral Ka harte Vendimi nuk u ankimua
Pashke	Dedja	Gjergj ; Pjeter	Pepaj	Sip. E papercaktuar	Velipoje / 3734	256	1000	1000	Ka vert.pronesia Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Haxhi	Bushati	Bahri	Bushati	1000m2 truall (tjetersuar ne TB)	Bushat / 1329	255	1000	1000	Ka vert.pronesia Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Kole	Tomori	Kin	Tomorri	Sip. E papercaktuar	Rec,Velipoje / 3160	254	6500	6500	Ka vert.pronesia Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Ujk	Pepa	Ujk	Pepa	5000m2 truall	Hot I Ri Rrethina / 1965	253	4400	4400	Ka vert.pronesia Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Tom	Gega	Luigj	Lepuri	3400m2 truall	Fshati Rranxe Bushat / 3205	252	3400	3400	Ka vert.pronesia Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Latif	Hysa	Haki	Hysa	1000m2 truall	Rrence / 3168	251		1000	Ka vert.pronesia Ka Harte Vendimi nuk u ankimua Ne deispoziti v nuk eshte shenbuar sip por citohet se l njihet e drejta e kompensimit per sip truall tjetersuar ne TB, e cila sipas arsyetimit vendimit dhe hartes eshte 1000 m ²
Mark	Alia	File	Nako	15800m2 truall	Samrishi I Vjeter / 3257	250	10580	10580	Ka vert.pronesia Ka Harte Vendimi nuk u ankimua
Pjeter	Hiluku	Pjeter	Zefi	11100m2 truall	Shelqet / 3334	369	11100	9000	Vendimi nuk u ankimua
Gjon	Nika	Lazer	Nikaj	8000m2 truall	Qyrac Lac Vau Dejes/	368	6400	1000	Ka vert.kadastral Ka harte
Cafo	Bashi	Caf	Bashi	1500m2 truall 1130m2 truall	Shtoj I Ri / 3428	367	9630	8130	Ka VFJ Ka vert.kadastral Ka harte
Pal	Gjoka	Kanto	Gjoka	6000m2 truall	Rec I Ri / 3159	366	6000		Ka vertetim kadastral Ka harte
Kisha Katolike		Kisha Katolike		7000+2550m2 truall	Dobrac / 1495	365	9950		Ka vert.kadastral Ka harte
Rrok	Coba	Ferdinad	Coba	15 dy truall	Gur I Zi / 1989	364	2100	1150	Ka vert.hipoteka Ka note transkript i Ka Harte
Trashigim taret Meta		Hajrullah	Meta	740 m ² truall	Vukatan / 3838	363	740		Ka vert.pronesia Ka skica
Luka ; Prenda	Zhuri	Martin	Zhuri	2804 m2 truall	Bene Shllak / 1150	362	2804	2804	Ka VFJ Ka Harte
Gjoke	Vata	Alfons	Vata	10000m2 truall	Rec I Ri / 3159	361	10000	10000	Ka vert.kadastral Ka harte
Ndok ; File	Ndoka(M arashi)	Ndue	Marashi	15000m2 truall	Rec I Ri / 3159	360	10500	8500	Ka vert.kadastral Ka harte
Martin	Kapa	Gjyste	Kapa	5500m2 truall	Rec Velipoje /3160	359	5500	5500	Ka vert.kadastral Ka harte
Pjeter	Pjetri	Zef	Pjetri	250m2 truall	Gomsiqe / 1799	358	250	250	Ka vert.kadastral Ka harte
Ibrahim	Kerpalla	Safije	Kerpalla	7497m2 truall	Shtoj I vjeter Rrethina / 3429	357	7500	7500	Ka VFJ+Harte
Musa ; Shyqyri	Nehani	Orhan	Nehani	10000m2 truall	Shkjez / 3389	356	10000	10000	Ka note transkript i Ka harte
Nut	Myrtja	Nut	Myrtja	3580m2 truall	Shiroke / 8591	355	3580		Ka vert.kadastral Ka Skice
Maliq	Xhyheri	Rudina	Troshani(Xhyheyri)	13500m2 truall	Berdice Berdice / 1157	354	8250	8250	Ka VFJ+Harte
Riza	Nehani	Nexhip	Nehani	10000m2 truall	Berdice e Siperme / 1159	353	10000	10000	Ka note transkript i Ka harte
Broz	Pema	Broz	Pema	1000m2 truall	Obot / 2819	352	1000	1000	Ka VFJ+Harte
Nikolle	Berisha	Ded	Berisha	10000m2 truall	Grude e Re / 1869	351	10000	10000	Ka vert.kadastral Ka harte
Shan	Marku	Ndoc	Marku	2000m2 truall	Gur I Zi / 1989	350	600	600	Ka vert.kadastral Ka harte
Fran	Zefi	Fran	Marku	10000m2 truall	Luarze Velipoje / 2500	349	10000		Ka vert.kadastral Ka harte
Zef	Maci	Marash	Maci	11000m2 truall	Casd Velipoje /1358	348	11000	11000	Ka vert.kadastral Ka harte
Luk	Tanushi	Zef	Tanushi	8950m2 truall	Lac,Vau Dejes / 8598	347	8950	1450	Ka vert.kadastral Ka harte
Zef ; Dila	Tanushi	Bibe	Tanushi	10250m2 truall	Lac,Vau Dejes / 8598	346	10250	3000	Ka vert.kadastral Ka harte

(Vijon nesër)

Opinion i Ditës

Ç'të mirë panë shqiptarët nga qeverisja e të majtëve

Nga Delvina Kërluku

(vijon nga faqja 1)

... në kontot e partive maqedonase, konkretisht të LSDM-së. Përflitet se ky numër mund të ketë qenë edhe 70.000, që është pak e besueshme, por se ka qenë 35 - 40.000, as që diskutohet. U ngrit zhurmë e madhe për këtë lloj votimi, pasi i kalon përmasat e normales. Kjo s'do të thotë se në të kaluarën shqiptarët nuk i kanë votuar maqedonasit dhe partitë e tyre, por numri ka qenë i papërfillshëm. Se ka pasur vota shqiptare për "të tjerët", këtë e dëshmojnë zgjedhjet presidenciale, ky apo ai kandidat është bërë president me votat shqiptare.

Tani na imponohet një pyetje fare e thjeshtë e fare konkrete: ç'të mirë panë shqiptarët nga qeverisja e të majtëve kur ata ishin në pushtet, gjithnjë me ndihmën e votës shqiptare, por të tërthortë, pra me ndihmën e PPD-së. Për ata që kanë kujtesën dhallë, mjafton t'ua përkujtojmë ngjarjet tragjike të Bit Pazarit, të Ladorishtit të Strugës, vrasjen e Adylselamit me rastin e hapjes së Universitetit të Tetovës, paralelet e përziera (ku në klasa kishte 30 shqiptarë e 3 maqedonas e që procesi arsimor zhvillohej në maqedonisht), përdorimi i toponimeve në trajtën e tyre sllave, emërtimi i shkollave,



rrugëve, institucioneve...

Duam t'i pyesim këta shqiptarë: mos janë pak të shpejtuar? Mos ua ka errësuar interesi personal ose ai i ngushtë lokal që të votojnë parti maqedonase, edhe në kushtet kur mundësia e zgjedhjes së ofertave nga partitë shqiptare ekziston? Ata duhet ta

dinë se fuqizimi i partisë maqedonase në dëm të asaj shqiptare, është një e keqe që kërkon çmim. E këtë çmim sot a nesër, do ta paguajmë ne shqiptarët... Një porosi: zgjedhjet lokale që po vijnë është një shans e rast i mirë për t'u kthjelluar, duke votuar vetveten. Në dibranët kemi një

shprehje autoktone: Më mirë e më të keqin e vendit tonë, me atë do të merremi, se sa me një të huaj. Ndonëse jetojmë me dekada në një shtet, maqedonë e shqiptarë, e ca serbë, vllhe, romë, boshnjakë... përsëri mbetemi të huaj për njëri-tjetrin. Sepse në përherë duhet të dimë se një miq-

si është e humbur kur duhet të mendojmë mbrojtjen. Ç'kënaqësi është sot të shoqërohemi me një parti maqedone, anëtarë e së cilës ndjekin modelin që lanë ata të dekadave më parë! Jemi të vendosur t'i bindemi urdhrat të të parëve tanë që të shfaqim dashuri të singertë për njëri-tjetrin. Bashkëpunimi ndërmjet shqiptarëve nxjerr në pah më lehtë problemet dhe po në të njëjtën formë mund të zgjidhen, duke punuar për të njëjtin qëllim. Ne gjithashtu duhet të mbështesim njëri-tjetrin me përpjekjet dhe punën tonë, qoftë fizike. Në kështu e bëjmë menjëherë atë që armiqët tanë s'duan që ne ta bëjmë. Nëse ky është rasti për armiqët tanë, atëherë si duhet të sillemi me miqtë tanë? Ne duhet të shprehim gatishmëri e vullnet të mirë për kandidatët shqiptarë. Ndonëse kësaj here është shpesh-tuar numri i kandidatëve, por sot kemi kë zgjedhim. Pra, një politikan të mirë për shqiptarët, që duhet të zbrësë nga qielli i të ecë në tokë, të zgjohet nga ëndrrat e të përballet me realitetin. Një njëri që të jetë një politikan që e vë veten në shërbim të popullit, e jo një politikan që është një shtetar që e vë popullin në shërbim të vetes. Pra, politika është një gjë tepër serioze për t'ia lënë cillitdo, politikanëve. Dhe atyre, ringjallësve të fantazmave më të këqija të historisë së të majtës.

Intervista e Ditës

Albin Kurti: Përplasja ime me Edi Ramën. Deklarata e tij, mungesë informacioni

Albin Kurti flet në një intervistë për gazetën "Tema" në lidhje me përplasjen që pati me Edi Ramën, zhvillimet në Kosovë, dhe idenë e vazhdueshme të tij për bashkimin kombëtar.

Kurti, para disa ditësh ju reagat ndaj deklaratës së Kryeministrit të Shqipërisë, z. Rama lidhur me qëndrimin e Kryeministrit të Kosovës për demarkacionin e kufirit Kosovë-Mali i Zi; çfarë ju shqetësoi aq shumë në atë deklaratë?

Mendoj se deklarata e z. Rama ka ardhur si pasojë e mungesës së informacionit të plotë mbi çështjen, ose si pasojë e ndonjë keqinformimi të porositur nga kanale të kontrolluara prej z. Thaçi, i cili është shumë i interesuar që të zbatohet marrëveshja e padrejtë për demarkacionin. Por ajo marrëveshje nuk do të zbatohet, për shkak se argumentet e ekspertëve, por edhe dokumentet tregojnë se ajo linjë demarkacioni është gabim. Sigurisht që do të ketë një marrëveshje tjetër për demarkacionin, dhe do të vendoset linja e drejtë kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi. Është për t'u vlerësuar se pala malazeze nuk po këmbëngul në vijën kufitare që pretendon Thaçi, dhe është e hapur për diskutim. Ne reaguam për të korrigjuar atë që neve na u duk qëndrim i gabueshëm. Por mendojmë se ky debat tashmë është i mbyllur, pasi vetë z. Rama e pranoi se ai është një person që nuk

fal as det e as tokë, dhe kjo është pikërisht ajo cka ne presim prej tij e prej çdo politikani shqiptar. Deti e toka e shqiptarëve janë të dyja njësoj të rëndësishme, dhe janë çështje e sovranitetit të jashtëm kombëtar, dhe si të tilla, nuk i përkasin politikaneve, por popullit. Andaj mendoj se asnjë politikan nuk duhet të falë as det e as tokë.

Nga reagimet e autoriteteve të Malit të Zi dhe SHBA-ve e BE-së duket se nuk është temë e pëlqyeshme rihapja e përmbytjes së marrëveshjes së demarkacionit. A besoni se komisioni që emëroi Kryeministri Haradinaj me ekspertë që e kundërshtonin demarkacionin, do të ketë kurajën ta mbrojtë qëndrimin para partnerëve ndërkombëtarë?

Temë e pëlqyeshme për ta mund të mos jetë, sepse sigurisht që janë të interesuar në vonimin e marëveshjes së demarkacionit, por veç në korrigjimin e saj. Kufiri duhet të jetë i drejtë, sipas dokumenteve e hartave historike.

Po e përsëris që ne nuk jemi të interesuar në vonimin e marëveshjes së demarkacionit, por veç në korrigjimin e saj. Kufiri duhet të jetë i drejtë, sipas dokumenteve e hartave historike.



Kam shpresë se ekspertët dhe shkencëtarët që kanë integritetin profesional do ta mbajnë qëndrimin të njëjtë. Po ashtu, mendoj se z. Haradinaj nuk do të lëshojë pe në këtë drejtim. Ai e ka pohuar këtë edhe vetë, në një përgjigje që i ka dhënë z. Rama.

Si mendoni ju që do të zgjidhet drejt dhe pa pasojë marrëveshja e paratifikuar nga Kuvendi i Kosovës për versionin "Thaçi" të demarkacionit?

Marrëveshja duhet të rinegociohet. Por versioni mbi të cilin duhet

të nisë rinegocimi, duhet të jetë një version i punuar prej akademikëve dhe ekspertëve të hartografisë e gjeografisë historike.

Ky rinegocim nuk e pengon asnjë proces të rëndësishëm gjeopolitik. Tashmë Mali i Zi është në NATO, dhe Kosova është sigurisht aspirante për integrimet euroatlantike, pra parimisht ne jemi në të njëjtën anë gjeopolitike me Malin e Zi. Kjo situatë e favorizon mirëkuptimin mes Kosovës dhe Malit të Zi. Kosova nuk kërkon tokë të Malit të Zi, dhe Mali i Zi nuk besoj që kërkon

tokë të Kosovës. Në fakt, ajo që quhet marrëveshje e demarkacionin nuk është as marrëveshje dhe as demarkacioni, sepse nuk mund të jetë marrëveshje përderisa nuk ratifikohet në Kuvendin e Kosovës dhe as demarkacionit përderisa Komisioni paraprak ka bërë delimitim, përkatësisht ndryshim kufiri, e jo demarkacion. Ajo "marrëveshje e demarkacionit" ngeli veçse një ujdi e ministrave të asokohshëm të jashtëm e të brendshëm, z. Hashim Thaçi dhe z. Skënder Hyseni, me homologët e tyre malazezë.

Nëse sërish ju vlen në Kuvendin e Kosovës në mospërputhje për çfarë janë kërkesat tuaja, a do t'i shohim sërish skenat e dy viteve më parë?

Nuk besoj që do të vijë kjo marrëveshje në Kuvend. Qeveria aktuale është shumë e dobët dhe në çdo moment mund ta humbasë shumicën, ndaj nuk besoj se do të merren me çështje problematike si demarkacioni e "Zajednica". Ne presim nga ky qeveri të merret me zhvillimin ekonomik, vendosjen e drejtësisë, luftimin e korrupsionit. Nëse kjo qeveri dëshiron t'i hapë probleme vetes, atëherë do të jetë më keq për të. Sa u përket protestave në Kuv-



Opinion i Ditës

Kjo nuk është as opozita, as parlamenti që na duhet

Nga Mentor Kikia

(vijon nga faqja 1)

... shernajës së vjetër, me grindje, sharje dhe protesta.

Në fakt, unë prisja sot miratimin e komisionit të reformës zgjedhore. Ligjit më të rëndësishëm dhe më emergjent.

Sepse pa u reformuar sistemi zgjedhor, nuk ka për t'u reformuar as parlamenti, as qeveria e as politika në tërësi.

Sepse sistemi zgjedhor është struktura që ndikon në ngritjen e ngrehinës së demokracisë dhe kjo strukturë tek ne është e degraduar, e ndryshkur, e kalbur, e deformuar.

Dhe falë kësaj strukture, në parlament futen edhe horrat, edhe hajdutët, edhe injorantët, sepse populli nuk di të voton, sepse deputetët i emëron partia.

Por në vend të komisionit të



kësaj reforme, pamë sërish përplasje. Përplasje për të folur!

Jo zotërinj, nuk na duhen demagogjira, na duhet punë konkrete.

Po, na duhen përplasje, edhe

grushte madje po qe nevoja, por na duhen për të mbrojtur interesat e popullit, për të penguar një ligj të mbrapshtë, për të penguar një vendim që nxit vërdhjet dhe abuzimin, për të penguar një

koncesion hajdutësh.

Por këto ju i votoni të gjithë, unanimisht, pa bërë zë, si hije, të tërë.

Kjo nuk është politika që duam, nuk është as opozita që duhet.

end, nuk besoj se do të ketë nevojë më, për arsyt që përmenda më lart, por edhe për faktin se tashmë Lëvizja Vetëvendosje! është dyfishuar; ndërsa në koalicionin qeverisës ka deputetë që nuk do të pajtoheshin me atë demarkacion. Jemi në gjendje t'i ndalim pa pasur nevojë për skena të tilla.

Ju e kemi vënë në diskutim plotfuqishmërinë dhe legjitimitetin e qeverisë "Haradinaj", së fundi edhe në kontestimin e ministrit serb Nenad Rikallo; pse mendoni që Haradinaj është i papërshtatshëm për Kryeministër?

Ministri Rikallo është akuzuar nga ish-funinjët e vet për keqtrajtimit e dhunime para e gjatë luftës. Një njeri i tillë është i papranueshëm, jo vetëm për Lëvizjen Vetëvendosje, por edhe për mbarë shqiptarët e Kosovës. Ne nuk e kontestojmë atë për shkak se është serb, pasi ka shumë serbë të Kosovës, ndoshta shumica e tyre, që nuk janë përfshirë në krime e keqtrajtimit ndaj shqiptarëve. Mirëpo, ne po kontestojmë personin, individin Rikallo, për të cilët shumë qytetarë të Kosovës kanë mbledhur dëshmi që e implikojnë në raste të tilla. Janë njëzet dëshmitarë që janë lajmëruar! Kryeministri Haradinaj nuk duhet të fshihet prej përgjegjësisë duke thënë se e ka pyetur Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, Policinë apo Prokurorinë e Kosovës. Përballë ka dëshmitë e mbledhura prej qytetarëve të vendit të tij, ai duhet të shkarkojë ministrin Rikallo në mënyrë që të nisin hetimet e pavarura. Mirëpo, po duket se Haradinaj nuk guxon të sfidojë Listën Serbe e cila ia garantoi qeverisjen.

Ju kemi politikani më i votuar në Kosovë, për disa muaj rresht, pas zgjedhjeve gjithkush priste që ju të formoni qeverinë. Çfarë ndodhi? Çfarë nuk shkoi mirë me Isa Mustafën e Behgjet Pacollin?

Ne kemi qenë të hapur, madje të interesuar për bashkëpunim, dhe kemi kontaktuar vazhdimisht me partitë e tjera, LDK e AKR. Mirëpo nga z. Mustafa nuk ka pasur shumë interesim. Prej mesit të korrikut e deri në shtator ai nuk ka kontaktuar fare me ne. Mungesa e interesit nga z. Mustafa kontribuoi në largimin e z. Pacollit, i cili më pas u bashkua me qeverisjen Haradinaj. Z. Mustafa nuk ka treguar seriozitetin e nevojshëm për ta dërguar PDK-në në opozitë, dhe kjo është hera e dytë. Hera e parë ka qenë në vitin 2014, kur nuk i rezistoi presionit dhe shkoi vetë në koalicion me PDK, hera e dytë është tani, kur u mënjana, dhe e pamundësioi koalicionin me Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK. Megjithatë, Lëvizja Vetëvendosje po rritet, dhe do të vazhdojë të rritet. Tashmë jemi subjekt i parë parlamentar në Kosovë, dhe së shpejti do të fitojmë disa komuna të mëdha anembanë Kosovës. Nuk është këtu çështja se Albin Kurti është deputeti më i votuar, por çështja është se disa komuna do të mund t'i fitojmë pa balotazh dhe mbi dhjetë sosh gjithsej pas balotazhit.

Ju folët këto ditë për modelin gjerman të bashkimit duke rikujtuar kauzën e bashkimit të shqiptarëve. Gensher në 1989 i korrigjoi gazetaret ndërkombëtarë duke saktësuar se nuk bëhej fjalë për "ribashkimin e Gjermanisë" por për "bashkimin gjerman". A kemi në Shqipëri një arkitekt, një Uilli Brand apo një Helmut Kol?

Ka dy qëndrime për këtë çështje. Britania, Franca, Italia e Polonia, të cilat ishin kundër bashkimit të Gjermanive për arsye vetjake, e quajtën "ribashkim", pasi ishin të interesuar që kjo të tingëlonte si një ripërseritje e historisë. Ndërsa gjermanët, edhe në rastin e Gensherit që përmendni ju, por edhe në shumë raste të tjera, edhe sot e kësaj dite, e quajnë "bashkim". Pasi është hera e parë që këto dy vende bashkohen, por edhe për shkak se nuk ka asnjë histori që të të përsëritet. Gjermania e bashkuva demokratikisht, me një perspektivë të progresit, të vlerave njerëzore, por edhe të evropianizmit. Këtë mund ta shohim edhe sot. Bashkimi i Gjermanive solli mirëqenien e zhvillim për gjermanët, por edhe një shtyllë të fortë për projektin evropian. A e kemi në një Vili Brand apo një Helmut Kol, unë këtë nuk e di, pasi mendoj se rasti i Shqipërisë dhe i Kosovës ka dallime të mëdha me rastin e Gjermanisë. Në fakt e vetmja ngjashmëri është se kemi të bëjmë me kombe që dëshirojnë të bashkohen. Por Shqipëria e Kosova kanë përparësi të mëdha, për shkak se në historinë e tyre nuk e kanë ndonjë moment që i bënë fajtor, siç e pati Gjermania momentin e Luftës së Dytë Botërore. Ne si shqiptarë nuk ka nevojë të kemi komplekse. Bashkimi jonë nuk rrezikon asnjë funj, dhe ne nuk kemi në historinë tonë "njolla". Bashkimi jonë duhet të jetë dhe do të jetë demokratik, progresist, i fokusuar të zhvillimit ekonomik dhe institucional i shqiptarëve, në marrëdhënie korrekte me funjinjtë, dhe evropianist.

Ju folët këto ditë për modelin gjerman të bashkimit duke rikujtuar kauzën e bashkimit të shqiptarëve. Gensher në 1989 i korrigjoi gazetaret ndërkombëtarë duke saktësuar se nuk bëhej fjalë për "ribashkimin e Gjermanisë" por për "bashkimin gjerman". A kemi në Shqipëri një arkitekt, një Uilli Brand apo një Helmut Kol? Ka dy qëndrime për këtë çështje. Britania, Franca, Italia e Polonia, të cilat ishin kundër bashkimit të Gjermanive për arsye vetjake, e quajtën "ribashkim", pasi ishin të interesuar që kjo të tingëlonte si një ripërseritje e historisë. Ndërsa gjermanët, edhe në rastin e Gensherit që përmendni ju, por edhe në shumë raste të tjera, edhe sot e kësaj dite, e quajnë "bashkim". Pasi është hera e parë që këto dy vende bashkohen, por edhe për shkak se nuk ka asnjë histori që të të përsëritet. Gjermania e bashkuva demokratikisht, me një perspektivë të progresit, të vlerave njerëzore, por edhe të evropianizmit. Këtë mund ta shohim edhe sot. Bashkimi i Gjermanive solli mirëqenien e zhvillim për gjermanët, por edhe një shtyllë të fortë për projektin evropian. A e kemi në një Vili Brand apo një Helmut Kol, unë këtë nuk e di, pasi mendoj se rasti i Shqipërisë dhe i Kosovës ka dallime të mëdha me rastin e Gjermanisë. Në fakt e vetmja ngjashmëri është se kemi të bëjmë me kombe që dëshirojnë të bashkohen. Por Shqipëria e Kosova kanë përparësi të mëdha, për shkak se në historinë e tyre nuk e kanë ndonjë moment që i bënë fajtor, siç e pati Gjermania momentin e Luftës së Dytë Botërore. Ne si shqiptarë nuk ka nevojë të kemi komplekse. Bashkimi jonë nuk rrezikon asnjë funj, dhe ne nuk kemi në historinë tonë "njolla". Bashkimi jonë duhet të jetë dhe do të jetë demokratik, progresist, i fokusuar të zhvillimit ekonomik dhe institucional i shqiptarëve, në marrëdhënie korrekte me funjinjtë, dhe evropianist.

Sot u bënë 17 vjet që prej rrëzimit të Millosheviçit në Serbi; çfarë mund të thuhet sot për ndryshimet atje?

U rrëzua Millosheviçi, por jo edhe regjimi i tij. Rrjedhimisht, trashëgimia e tij politike dhe ideologjike gjallon. Meqë kanë ndryshuar rrethanat, kanë ndryshuar edhe mjetet e mënyrat, porse jo motivet e qëllimet, premisat e synimet. Mbaje vrasja e ish kryeministrit serb, Zoran Gjingjiç, më 12 mars 2003, e fundosi potencialin demokratizues e progresist në Serbi. Sot, grupi më i madh i miqësisë në Kuvendin e Serbisë është ai i miqësisë parlamentare Serbi-Rusi me 131 deputetë jo gjithsej 250 sa ka Kuvendi atje! Jo vetëm që Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe mirëmban strukturat e saj paralele në çerekun e territorit të Kosovës të lëna aty nga Millosheviçi në vitin 1999, por ajo nuk ndjen kurrfarë pendese për krimet nga e kaluara. Për të qenë edhe më keq se kaq, me proces gjyqësor në Serbi është rehabilituar figura e kryeçetnikut Drazha Mihajloviç dhe kjo tash po bëhet edhe me kryeministrin e qeverisë pro-naziste gjatë Luftës së Dytë Botërore, Milan Nediç.

Së fundi, por jo për nga rëndësia, çfarë rezultati prisi për Vetëvendosjen në zgjedhjet lokale të 22 tetorit?


Kandidatët i kemi shumë të mirë, programin edhe më të mirë. Unë nuk jam i përfshirë në shtabet zgjedhore personalisht, shkoj vetëm në aktivitetet ku jam i ftuar, por me sa po shoh ka entuziazëm të madh. Sondazhet na tregojnë se organizata jonë do të fitojë më shumë se gjysmën e komunave në Kosovë. Pasi që nga zgjedhjet e 11 qershorit u bënë partia më e madhe në Kuvend, subjekti i parë në vend, pas zgjedhjeve të 22 tetorit, përkatësisht balotazhit të 19 nëntorit, në qeverisjen tonë lokale do të kemi shumë më tepër komuna se cilado parti tjetër. Fitorja jonë e 11 qershorit do të thellohet dhe zgjerohet.

A vertical sidebar on the right side of the page containing horoscope columns. Each column has a title (DASHI, DEMI, BINJAKET, GAFORJA, LUANI, VIRGJERESHA, PESHORJA, AKREPI, SHIGJETARI, BRICJAPI, UJORI, PESHQIT) and a small image of the zodiac sign. The text in each column provides astrological advice for that sign.

Table with columns: NR. DOSIES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, VENELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, VENELIN DIA, KOPJE TE LETER NQFTIM, NUMER PERSONAL, LLOGAR I BANKAR E, CERTIFIKATE BANCARE, KATE BANCARE, DESHMI TRASHGIM ME.

Table with columns: NR. DOSIES, EMER, MBEMER, VKM NR., ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, VENELIN DIA, EMER, ATESTA, MBIEMER, DATELIN DIA, VENELIN DIA, KOPJE TE LETER NQFTIM, NUMER PERSONAL, LLOGAR I BANKARE, CERTIFIKATE BANCARE, KATE BANCARE, DESHMI TRASHGIM ME.

Fjalëkryqi (1)



- 40. Pak imagjinatë.
- 42. Pikat pa kufij
- 43. Fillojnë aksionin.
- 44. Kërkohej nga poetët.
- 47. Nota e diapazonit.
- 48. I prin kolonës.
- 51. Eshhtë filozofie moralit.
- 52. Ulet në dhomën e lartë.

VERTIKAL

- 1. Malet pa kufij.
- 2. Janë banorë imagjinarë të planetit të kuq.
- 4. Inicialet e Altman.
- 5. Një sportist që arrin majat
- 6. Courier ish-kampion i tenisit.
- 7. Fillojnë testin.
- 8. Mund të jetë parabolike.
- 9. Bie me ballë.
- 10. Carnera, ish-kampion i ringut.

HORIZONTAL

- 1. Bëjnë arte me re.
- 2. Krijoi Arsene Lupin (inic).
- 3. Janë forma.
- 10. Në hyrje të plazhit.
- 11. Kapen të parat.
- 13. Janë ufot.
- 14. Mbahen nga ata që i thyejnë.
- 18. Inicialet e Mascagni-t.
- 19. Në krye të trupave.
- 20. Eshhtë edhe ai i Këngëve dhe valleve.
- 22. Pak hemorrhagji.
- 23. U shkrua nga Jack London.
- 25. Institucione Ndërkombëtare Europiane.
- 26. Scarlet e Bashkë me erën.
- 27. Janë tituj në ekran.
- 29. Eric aktor.
- 31. Kështu e ka syrin vigjilent
- 32. Janë nofka.
- 35. Një provë... inteligjence.
- 37. Mund të jenë me sahat.
- 38. Një pjesë e naivitetit.

- 11. Lidhet mes punëtorit dhe punëdhënësit
- 12. I kanë rrënjët në tokë.
- 15. Eshhtë pushkë.
- 16. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
- 17. Takim Brezash Durrës.
- 21. Ishte lumi i Elizit
- 22. Eshhtë kardinal.
- 24. Mbyllin një krah.
- 28. Artikull anglez.
- 30. Mbyllin fushatat.
- 31. Partia pa ara.
- 32. Zola që shkroi Nana
- 33. Ngarjherë duhen vënë mbi i.
- 34. Një fjalë kastle
- 36. Inicialet e Mann shkrimtar.
- 39. Maiden që këndojnë.
- 41. Ai i shtatë është kinemaja.
- 43. Fillojnë arsyetimin.
- 45. Eshhtë nënë e Tironës.
- 46. Eshhtë shahu i fundit.
- 48. Inicialet e Klee piktor.
- 49. Dy asa.
- 50. Mbarojnë fare

Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL:


- 1. Patricia këngëtare.
- 5. I vocërr ai i Migjenit
- 9. Hari spiune.
- 12. Qyteti i Robespierre.
- 14. Phineas i famshëm i cirkut.
- 16. Pak latinisht.
- 17. Inicilet e Banderas.
- 19. Janë tek në rrota.
- 20. Pak efikasitet.
- 22. Eshhtë shkolla fillore.
- 24. Arrihet duke aderuar
- 27. Pak iniciativë.
- 28. Një... art i Don Judd.
- 29. U kompozua nga Rachmaninov.
- 31. Diku në qendër.
- 32. Një është për të lidhur.
- 33. Jepet për hartim.
- 35. Sergej, poet i famshëm rus.
- 37. Veriu pa kufij.

VERTIKAL:


- 39. Mbyllin një tender.
- 41. Një pjesë analogjisë.
- 42. Mjeku pa ju.
- 43. Nisin nga kreu.
- 44. Një racë kombi.
- 46. Një rapper i famshëm.
- 49. Një pikë... vaji.
- 50. Në fund majtas.
- 51. Ndizen me një çelës.
- 53. Emri i Delon
- 54. Janë të dërguar specialë

VERETIKAL

- 1. Eshhtë edhe ai i sheqerit.
- 2. Eshhtë lloj papagalli.
- 3. Një Pop i Andy Warhol.
- 4. Sapo fillojnë.
- 6. Qendër në Kubë.
- 7. Eshhtë pluhuri si Dash.
- 8. Eshhtë e hollë dhe therëse.
- 9. Fillojnë muzikën.
- 10. Një kontinent i ri.
- 11. Eshhtë për medaljen e parë.
- 13. Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve.
- 15. Provinca e boerëve.
- 18. Eshhtë qyteti i njëmbinjë dritareve.
- 21. Eshhtë dukuria.
- 22. Eshhtë hidrokarbur.
- 23. Griffith aktore.
- 25. Qe perëndesha e fitores.
- 26. Mbeten në fund.
- 30. Tregon çmimin.
- 34. Këndohet në opera.
- 36. Para Fe në New Mexico.
- 37. Eshhtë princ arab.
- 38. Tony që këndon Quando, quando, quando.
- 40. Bën mëza.
- 45. Pak tolerante.
- 47. Modem pa zë.
- 48. Pak marramendëse.
- 50. Mbyllin një dyqan.
- 52. Fillojnë teorikisht.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Argëtim filozofik

- I virtytshmi nuk mund të plagoset dhe dhimbja që tjerët duan t'i shikojnë, bie mbi vetë ato.
- Mos i beso asgjëje, s'ka rëndësi ku e ke dëgjuar ose kush e ka thënë, edhe sikur ta kem thënë unë, vetëm nëse është e pranueshme dhe e kuptueshme për arsyen tënde.
- Kush nuk ka plagë në dorë mundet të prekë helmim me atë dorë; helmi nuk penetron aty ku nuk ka plagë; dhe nuk është mëkat (vepra) për ata që nuk e ka mëkat.

Thënie të mënçura

- Përballu me sjelljen e keqe në mënyrë të këndshme.
- Testimi i vërtetë i sjelljeve të mira, është të jetë në gjendje të përballat sa më mirë me sjelljet e këqija.
- "Kurrë mos lini pas dore një mundësi për përmirësim."

Khalil Gibran
Sir William Jones

- Kur jam i lumtur, shoh lumturinë edhe tek të tjerët. Kur jam i mërzitur, vë re që sytë e njerëzve janë të trishtuar.
- Kur jam i lodhur, e shoh botën sa të mërzitshme edhe jo tërheqëse. (Steve Chander)
- S'ka gjë më të tmerrshme se sa të shikosh injorancën në veprim. Johann Wolfgang Goethe (1749-1832)

SUDOKU

	1			8	6		7	9	
			3				4	2	6
4	5			7		8			
				5	8	2			
9		5				1		8	
		2	7	9					
		7		4			1	3	
6	4	9			1				
8	3		2	6			5		


Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	2	5	7	4	8	1	3	6
8	3	4	1	6	2	5	9	7
1	6	7	5	9	3	4	8	2
6	5	9	2	8	7	3	4	1
3	8	2	4	1	5	6	7	9
7	4	1	9	3	6	8	2	5
2	7	8	6	5	4	9	1	3
4	9	6	3	2	1	7	5	8
5	1	3	8	7	9	2	6	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



- Kur jam i lumtur, shoh lumturinë edhe tek të tjerët. Kur jam i mërzitur, vë re që sytë e njerëzve janë të trishtuar.
- Kur jam i lodhur, e shoh botën sa të mërzitshme edhe jo tërheqëse. (Steve Chander)
- S'ka gjë më të tmerrshme se sa të shikosh injorancën në veprim. Johann Wolfgang Goethe (1749-1832)

Khalil Gibran
Sir William Jones

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

